



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



D E P A R T A M E N T I I F I N A N C A V E D H E T A R I F A V E



RAPORT I DYTË PERIODIK PËR EFEKTET E TARIFAVE 2009-2011

PERIUDHA RAPORTUESE:
JANAR - SHTATOR, 2009

Parathënie

Ky raport paraqet një pasqyrë të treguesve kryesor operativ, financiar dhe atyre të investimeve kapitale të shtatë KRU-ve të realizuara nga to, në periudhën: 1 janar gjerë me 30 shtator 2009. Qëllimi i këtij raporti është i trefishtë:

- (i) Të jepet një informacion për trendin e treguesve operativ, financiar dhe të investimeve kapitale të KRU-ve, që do ti shërbejë si informacion ZRRUM-it dhe palëve tjera të interesit;*
- (ii) Të krahasohen treguesit e punës së KRU-ve me objektivat e përcaktuara në planet e tyre të biznesit dhe në rast të shmangieve të mëdha në këtë plan të mundësohet ndërmarrja me kohë e veprimeve korrektuese;*
- (iii) Të shikohen efektet potenciale të tarifave të reja të shërbimit të aprovuara nga ZRRUM për periudhën e ardhshme 3-vjeçare (2009-2011) dhe të shihen ndikimet e tyre në treguesit e punës së KRU-ve, dhe në veçanti efektet e ndikimit të tarifave në realizim të projekteve investive të aprovuar me procesin e theksuar rregullatorë për kompanitë e licencuara.*

Prezantimi i të dhënave në këtë raport përmbledh tri shtylla kryesore: a) të dhënat e realizuara të vitit 2008, b) të dhënat e planifikuara nga kompanitë dhe të lejuara nga ZRRUM për vitin 2009, dhe c) të dhënat e realizuara për treguesit operativ dhe financiar si dhe të investimeve kapitale për 9 muajt e parë të vitit 2009.

Të dhënat për këtë raport janë përmbledhur, përpunuar dhe analizuar nga Departamenti për Financa dhe Tarifa (DFT), ZRRUM gjatë muajit tetor 2009, në një proces i cili ka përfshirë tri faza të ndara: (i) fillimisht janë zhvilluar vizitat nëpër KRU, (ii) pastaj janë përpunuar dhe analizuar të dhënat e grumbulluara duke i marrë parasysh opinionet e kompanive, dhe (iii) është përpiluar ky raport. Me konkluzionet e këtij raporti do të njoftohen përfaqësuesit kompanive dhe palët tjera të interesuara në këtë sektor.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	4
2. ASPEKTET ADMINISTRATIVE.....	5
3. METODOLOGJIA TARIFORE	6
4. TREGUESIT OPERATIV, FINANCIAR DHE INVESTIV: JANAR-SHTATOR 2009.....	7
<i>4.1. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT</i>	<i>7</i>
4.1.1. TË DHËNAT E PRODHIMIT DHE FATURIMIT SIPAS KRU-ve	9
4.1.2. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT NË NIVEL TË SEKTORIT	11
4.1.3. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PËR UJIN E PRODHUAR DHE TË FATURUAR.....	12
<i>4.2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE.....</i>	<i>13</i>
4.2.2. SHPENZIMET OPERATIVE NË NIVEL TË SEKTORIT	17
4.2.3. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PËR SHPENZIME OPERATIVE PËR KRU-TË.....	17
<i>4.3. ANALIZA E FATURIMIT DHE INKASIMIT</i>	<i>18</i>
4.3.1. FATURIMI DHE INKASIMI SIPAS KRU-ve	19
4.3.2. FATURIMI DHE INKASIMI NË NIVEL TË SEKTORIT	22
4.3.3. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE TË FATURIMIT DHE INKASIMIT	23
<i>4.4. ANALIZA E INVESTIMEVE KAPITALE.....</i>	<i>24</i>
4.4.2. TË DHËNAT SEKTORIALE TË PËRGJITHSHME PËR INVESTIME KAPITALE	29
5. KONKLuzionET DHE REKOMANDIME	30
<i>Shtojca A: Procesi i Konsultimit me KRU-të për Gjetjet e Raportit</i>	<i>31</i>

1. HYRJE

Monitorimi i trendit të treguesve operativ, financiar dhe të investimeve kapitale të KRU-ve është i bazuar në planin e punës së DFT-ës të aprovuar në fillim këtij viti kalendarik. Ky plan i punës ka mundësuar ndërmarrjen veprimeve të duhura për të mbledhur, përpunuar, analizuar dhe raportuar për efektet e tarifave të përcaktuar në procesin tariforë 2009-2011, në mënyrë specifike për ndikimin e tarifave të vitit 2009 të përcaktuara për të gjitha kompanitë e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit (KRU-të) të licencuara nga ZRRUM.

Për këtë qëllim janë organizuar dhe realizuar vizita tek KRU-të, të cilat janë përgatitur dhe realizuar nga stafi i DFT-ë. Iniciativat e tilla janë dakorduar me menaxhmentet e KRU-ve. Në to janë definuar qëllimet e vizitave, nivelet e takimeve, dhe forma e pyetësorëve të dizajnuar paraprakisht për tu plotësuar për këtë aktivitet pune.

Me këta pyetësorë janë marrë të dhëna/shënime për një grup të treguesve kryesorë operativ-financiarë dhe ata të investimeve kapitale të realizuara në periudhën e trajtuar 9-mujore të 2009.

Edhe pse KRU-të janë paralajmëruar paraprakisht për kohën dhe qëllimin e vizitës, që të gjitha nuk kanë pasur të dhëna të përpunuara për këtë periudhë për ditët e takimeve edhe pse që të gjitha janë aranzhuar në bashkëpunim të plotë. Vetëm njëra prej kompanive (KRU "Hidrodrini") i ka pasqyruar të dhënat e veta vetëm për 8 muajt e parë të këtij viti dhe të gjitha tjerat për 9 muajt.

Analizat e veçanta për secilën kompani janë pasqyruar në formë të tabelave si dhe janë analizuar hollësisht në vijim të këtij raporti.

2. ASPEKTET ADMINISTRATIVE

Ndërmarrja e kësaj iniciative për monitorimin dhe analizimin e treguesve operativ dhe financiar të KRU-ve është mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-086, *Mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49, për Veprimtaritë e Shërbimeve të Ujësjellësve, Kanalizimeve dhe të Mbeturinave*, dhe të Rregullës R-02/UeK, e datës 12.08.2008, *Për Përcaktim të Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Ujësjellësit, Ujërave të zeza, dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë*, neni 26, pika a. dhe b. Konform akteve të mësipërme, ndërmarrja e një aktiviteti monitorues është përcaktuar edhe me Politikën Tarifore për Shërbimet e Ujit të nxjerrë nga ZRRUM në shtator 2007, si dhe me Planin e Punës për Vitin 2009 (pikat (ii) departamentet e ZRRUM-it, Departamenti për financa dhe tarifa rregullatore, synimi V, nga pika (i) gjerë te pika (vii), Raportet e veçanta përfundimtarë të vlerësimit dhe përcaktimit të tarifave afatmesme 2009–2011).

Identifikimi i efekteve të tarifave në caqet e përcaktuar të treguesve operativ-financiarë dhe ata investiv për këto tri vite (2009-2011) është vendimtarë për aktivitetet e mëtutjeshme të ZRRUM, i cili duhet të përcaktojë politika të cilat janë të ndërlidhura me afarizmin e kompanive dhe ngritjen e nivelit të shërbimeve të konsumatorëve të vet, sipas parimit të optimalizimit të treguesve të tillë të afarizmit të tyre.

Identifikimi i ndikuesve të brendshëm ose të jashtëm, ndihmon edhe për përmirësimin eventuale të performancës e që mund dhe duhet të bëhet me ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për korrigjim të politikave dhe caqeve të përcaktuara me tarifën e përcaktuara për dy vitet e mbetura (2010-2011) për menaxhmentet e KRU-ve.

Nga aspekti administrativ DFT/ZRRUM mund të ndërmerr veprime të caktuara administrative me qëllim të përshtatjes së rrethanave të reja të krijuara nga procesi tarifor, të cilat mund të jenë të ndikuar nga faktorët e theksuar në këtë publikim.

Të gjitha veprimet eventuale në pajtim me rrethanat apo situatat e caktuara që mund të paraqiten, do të ndërmerren pas konsultimeve të ndërsjella me palët e interesit.

3. METODOLOGJIA TARIFORE

Sikurse që kemi theksuar edhe në raportin e parë periodik, politika dhe metodologjia e përdorur për përcaktim të tarifave 2009-11, ishte e ndryshme nga ajo e përdorur në dy proceset tjera paraprake. Në fakt, mbështetur nga konsulentët ndërkombëtar ZRRUM ka zhvilluar metodologjinë e re tarifore bazuar në praktikën e mira të rregullatorëve tjerë ekonomik të shërbimeve të ujit, para së gjithash të atyre të Britanisë së Madhe, duke pasur parasysh specifikat tona aktuale. Kjo metodologji bazohet në kategoritë vijuese:

- (i) mbulimin e shpenzimeve operative dhe atyre të investimeve kapitale,
- (ii) marrjen parasysh të shumës së amortizimit për asetet jo-infrastrukturore,
- (iii) përcaktimin e vlerës rregullatore të kapitalit,
- (iv) normën e kthimit në vlerën rregullatore të kapitalit,
- (v) fillimin e mbajtjes së kontabilitetit rregullator për çdo kosto qendër veç e veç, me theks te veçantë të shërbimet ujësjellësit dhe atë të kanalizimit, etj.

Përdorimi i kategorive të këtilla ekonomike ka ndikuar që edhe politikat tarifore të ZRRUM të ndryshojnë dhe ti përshtaten rrethanave të reja të cilat kërkojnë monitorim periodik të lëvizjeve ekonomike të tregues kryesorë të KRU-ve. ZRRUM do të përcjell në vazhdimësi ndikimin e tarifave të përcaktuara edhe për periudhën e mbetur dy vjeçare 2010-2011, e cila do të vazhdohet të monitorohet me vizita të kohëpaskohshme nëpër kompani dhe nxjerrjen e të dhënave të mbledhura nga Departamenti i Performancës në ZRRUM nga raportimet që i bëjnë KRU-të në periudha të muajore.

Kalimi nga sistemi i përcaktimit të tarifave 1-vjeçare në atë 3-vjeçare ka ndikuar në ndërrimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave që llogaritet si pikë kthese për fillimin e realizimit të investimeve kapitale për:

- (i) sigurimin e burimeve të reja me ujë,
- (ii) zëvendësimin dhe zgjerim të rrjetit të ujësjellësit,
- (iii) ngritjen e nivelit të shërbimit etj.

Metodologjia e përcaktimit të tarifës bazohet mbi vlerën e tarifës e cila duhet të jetë e barabartë ose më e lartë se shpenzimet marginale afatgjate të investimeve të nevojshme kapitale, të llogaritura mbi bazën sasiore dhe cilësore të shfrytëzuesve të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Procesi tariforë zhvillohet duke marrë parasysh kostot operative-financiare, nga të cilat po numërojmë: kostot e kaptimit, prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijes, kostot e grumbullimit të ujërave të zeza, kostot e personelit, riparimet, investimet në infrastrukturën nëntokësore dhe mbi tokësore, amortizimin e aseteve jo-infrastrukturore, përcaktimin e vlerës rregullatore të kapitalit dhe në kuadër të kësaj edhe llogaritjen e normës së kthimit në kapital etj., që të gjitha këto futen në proporcion me sasinë e ujit të prodhuar.

Për secilën prej KRU-ve janë përgatitur pasqyrat e të hyrave të planifikuara në bazë të parasë së gatshme, ku është llogaritur edhe profiti i mundshëm në fund të çdo viti afarist, të cilin profit KRU-të duhet ta investojnë për ta zgjeruar bazën e tyre materiale, me të dhënat planifikuara të cilat janë akorduar mes ZRRUM-it dhe KRU-ve.

Edhe më parë dhe vazhdimisht kemi theksuar se mos përmbushja e planeve të investimeve kapitale, të cilat në vete përmbajnë profitin e kompanisë e të cilat kanë afektuar tarifën e

përcaktuara, ka për reperkusion rishikimin e tarifave për vitet pasuese, pasi që mund të konsiderohet se pa të drejtë janë ngarkuar konsumatorët me një pjesë të tarifës e cila nuk po përdoret për qëllimin e parapërcaktuar.

Zgjerimi i bazës së kostove të reja të cilat e kanë ngarkuar tarifën, sikurse u theksua edhe më lartë i jep të drejtë KRU-ve që mjetet e fituara financiare ti përdorin për investime kapitale, sikurse edhe ato të tjerat të huazuara mbi bazën e kredive komerciale apo edhe të tjerave.

Këto veprime merren në koordinim të ngushtë me menaxhmentet e KRU-ve (duke saktësuar afatet kohore paraprahe, metodologjinë, treguesit) dhe përmbillen me përpilimin e një raporti që pasqyron specifikat e çdo KRU-je.

Përmes monitorimit dhe analizimit të këtyre lëvizjeve tentohet të parandalohen ndikimet eventuale negative që mund të jenë shkaktarë të mosrealizimit të planeve të KRU-ve gjatë periudhës së mbetur 2-vjeçare dhe të ndërmerren veprime adekuate korigjuese në pajtim me rrethanat e reja të krijuara.

4. TREGUESIT OPERATIV, FINANCIAR DHE INVESTIV: JANAR-SHTATOR 2009

Treguesit e identifikuar si kryesorë, gjatë vizitave të bëra të stafit të DFT-ës nëpër KRU-t mbi bazën e të dhënave për 9 muajt e parë të këtij viti, të krahasueshme me shumën e parametrave kryesorë të aprovuar sipas procesit rregullatorë të tarifave nga DFT/ZRRUM të këtij viti dhe ato të realizuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2008, janë:

- (i) sasia e ujit të prodhuar,
- (ii) sasia e ujit të faturuar,
- (iii) shuma e inkasimit
- (iv) shuma e shpenzimeve operative,
- (v) numri dhe shuma e projekteve të planifikuara, realizuara dhe në realizim e sipër,

Në vijim do të pasqyrojmë të dhënat në formë tabelare për çdo KRU veç e veç dhe në fund të dhënat e tilla do ti përmbledhim si të përbashkëta për sektorin, me qëllim të krijimit të një pasqyre të plotë. Të njëjtat do ti ofrojmë edhe në formë grafike, dhe do të komentohen në pika të veçanta dhe të përgjithshme.

4.1. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT

Të dhënat e mbledhura për këtë grupim dhe të tjerat do ti paraqesim në formë tabelore të thjeshtësuar, me qëllim të krahasimit më të lehtë dhe verifikimit të dhënave të marra. Të dhënat e tilla sikurse theksuam janë për çdo KRU veç e veç dhe të përmbledhura për sektorin në fund.

Konkluzionet e nxjerra për kompanitë individuale do të jenë udhërrëfyes për përmirësim të performancës së tyre gjer në fund të këtij viti kalendarik dhe për të dy vitet tjera pasuese.

Tabela Nr.1 Të dhënat sasiore për ujin e prodhuar, faturuar dhe ujrat e zeza

Nr. Rënd.	Emritimi i KUR-ve	Të dhënat	Njësia	Historike 2008	Aprovuara nga ZRRUM 2009	Realizuar 2009
1	"Prishtina" Sh.A. Prishtinë (të dhënat 9 mujore)	Uji i prodhuar	m3	30,624,335	33,471,000	33,628,532
		Uji i faturuar		16,316,952	18,492,728	15,546,177
		Ujrat e zeza të faturuara		12,606,885	15,718,818	11,778,473
2	"Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë (të dhënat 9 mujore)	Uji i prodhuar	m3	12,604,523	12,435,000	13,103,525
		Uji i faturuar		6,326,627	6,976,471	6,405,822
		Ujrat e zeza të faturuara		-	3,225,185	2,857,943
3	"Hidrodrini" Sh.A. Pejë (të dhënat 8 mujore)	Uji i prodhuar	m3	22,774,235	20,000,000	19,013,314
		Uji i faturuar		5,803,002	4,950,081	4,969,086
		Ujrat e zeza të faturuara		-	2,079,034	
4	"Radoniqi" Sh.A. Gjakovë (të dhënat 9 mujore)	Uji i prodhuar	m3	12,785,831	13,318,352	11,306,800
		Uji i faturuar		4,797,539	6,601,125	4,673,226
		Ujrat e zeza të faturuara		-	3,663,624	2,686,302
5	"Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren (të dhënat 9 mujore)	Uji i prodhuar	m3	9,007,500	9,043,361	11,756,419
		Uji i faturuar		5,259,852	5,816,197	5,235,951
		Ujrat e zeza të faturuara		-	5,350,901	
6	"Bifurkacioni" Sh.A. Ferizaj (të dhënat 9 mujore)	Uji i prodhuar	m3	2,759,378	4,456,676	3,834,862
		Uji i faturuar		1,461,094	2,433,995	1,631,712
		Ujrat e zeza të faturuara		-	2,053,899	1,311,970
7	"Hidromorava" Sh.A. Gjiçan (të dhënat 9 mujore)	Uji i prodhuar	m3	4,385,922	6,652,500	5,175,525
		Uji i faturuar		2,202,958	3,907,470	2,265,426
		Ujrat e zeza të faturuara		-	3,555,798	
Sasia e përgjithshme		Uji i prodhuar	m3	94,941,723	99,376,889	97,818,977
		Uji i faturuar		42,168,023	49,178,066	40,727,400
		Ujrat e zeza të faturuara		12,606,885	35,647,259	18,634,688

Në vijim po i analizojmë shkurtimisht të dhënat e këtij grupimi të deklaruara nga KRU-të veç e veç dhe në fund të njëjtat po i komentojmë nga perspektiva e ZRRUM-it duke ofruar edhe sugjerimet tona eventuale për përmbushje të planave të përcaktuara me këtë proces.

4.1.1. TË DHËNAT E PRODHIMIT DHE FATURIMIT SIPAS KRU-ve

- **KUR "PRISHTINA" Sh. A. Prishtinë**

KRU "Prishtina" Sh. A. nuk i ka përmbushë disa nga treguesit e planifikuar gjatë 9 mujorit të parë të këtij viti. Uji i prodhuar ka kaluar sasisë e planifikuar për këta 9 muaj të vitit 2009 për 0.47%. Ndërsa, sasia e ujit të faturuar me ujë të furnizuar është ma e ulët për 15,93%, sikurse që është ma e ulët edhe sasia grumbullimit të ujërave të zeza për 25,07%, nga sasia e planifikuar për këta dy tregues për këtë periudhë kohore.

Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania sasinë e ujit të prodhuar e ka pas ma të lartë gjatë vitit 2009 për 9,81%, ndërsa, ka faturuar ma pak ujë për këtë periudhë kohore gjatë vitit 2009 për 4,72% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2008. Po ashtu e njëjta ka faturuar ma pak sasinë e ujërave të zeza të grumbulluara gjatë kësaj periudhe kohore për 6,57% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 46,72%, ndërsa gjatë këtij viti për të njëjtën periudhë kohore sasia e ujërave të humbura është ngritë në 53,77%. Çka do të thotë se kemi një ngritje prej 7,05%.

Angazhimi i saj duhet të drejtohet te faturimi i të dy shërbimeve për ti përmirësuar të dhënat e veta operative dhe financiare dhe zvogëlim radikalë të sasive të ujërave të humbura gjatë kuartalit të fundit të këtij viti dhe të viteve pasuese.

- **KUR "MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë**

Kjo kompani ka tejkaluar sasinë e planifikuar të ujit të prodhuar për 9 muaj të vitit 2009 për 5,38%. Në anën tjetër, faturimin e ujit të furnizuar për të njëjtën periudhë kohore e ka më të ulët për 8,18%, ndërsa sasinë edhe faturimin i grumbullimit të ujërave të zeza e ka ma të ulët për 11,39% nga sasia e planifikuar për faturim për këtë periudhë kohore.

Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania ka prodhuar ujë ma shumë gjatë vitit 2009 për 3,96%, sikurse që edhe ka faturuar ma shumë për 1,25% gjatë të njëjtës periudhë krahasimtare. Ndërsa shërbimin e ujërave të zeza nuk e ka të deklaruar për vitin 2008. Kompania është e suksesshme te prodhimi i ujit dhe të kundërtën e ka tek të dy shërbimet tjera.

Trendi do të përmirësohej dukshëm sikur dy parametrat e fundit të ishin në harmoni me planin.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 49,81%, ndërsa gjatë periudhës së njëjtë kohore të këtij viti të njëjtat janë ngritë në 51,11%, ose kemi një ngritje për vetëm 1,30% gjatë kësaj periudhe të këtij viti në krahasim me vitin 2008.

- **KUR "HIDRODRINI" Sh. A. Pejë**

Prodhimin e ujit të planifikuar për periudhën e shikuar kjo kompani e ka ma të ulët për 4,93%, ndërsa sasia e ujit të faturuar është ma e lartë për 0,38% nga sasia e planifikuar për këtë periudhë kohore të këtij viti. Sa i parke grumbullit të ujërave të zeza kompania nuk ka dhënë të dhëna të tilla.

Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania për këtë periudhë kohore ka prodhuar ma pak ujë gjatë këtij viti në krahasim me vitin paraprak për

16,51%. Po ashtu, kjo kompani ka faturuar ma pak gjatë kësaj periudhe të vitit 2009 për 14,37% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2008. Edhe në këtë rast kompania nuk ka ofrua të dhëna krahasuese për ujërat e zeza.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 74,52% dhe të njëjtat gjatë këtij viti kane rënë në 73,87%. Çka do të thotë se kemi një zbritje të sasisë së ujit të humbur për 0,65%.

Angazhimi i saj duhet të drejtohet te faturimi i të dy shërbimeve, zvogëlimin e humbjeve të ujit, mbajtjen e shënimeve për kosto grupet e shërbimeve etj. Mos deklarimi i të dhënave të tilla sipas shërbimeve dhe kontabilitetit rregullatorë mund të krijoj vështirësi për proceset tjera.

- **KUR "RADONIQI" Sh. A. Gjakovë**

Kjo kompani as një nga treguesit e planifikuar nuk i ka përmbushë gjatë 9 mujorit të parë të këtij viti. Prodhimi i ujit ka ngecë pa u përmbushë për 15,10%, faturimi i ujit të furnizuar për 29,21% dhe grumbullimi i ujërave të zeza për 26,68%.

Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania ka prodhuar ujë ma pak gjatë vitit 2009 për 11,57%, sikurse që edhe ka faturuar ma pak ujë për 2,59%. Për ujëra të zeza nuk kemi elemente krahasuese.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 62,48%, ndërsa gjatë kësaj periudhe kohore të këtij viti ato kanë rënë në 58,67% dhe ky tregues nuk është shumë pozitivë pasi që sasinë e ujit të prodhuar e kemi ma të ulët gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008. Çka do të thotë se kemi një zbritje të humbjeve të ujit për 3,81% e që nuk ka të bëjë me menaxhim ma të mirë të këtij procesi. Duket që kjo të jetë e kundërta e asaj.

Angazhimi i saj duhet të drejtohet tek të tre treguesit për ti përmbush synimet e saja të planifikuara për këtë vit, përndryshe edhe kjo kompani mund të vijë në vështirësi financiare nëse nuk bënë ndonjë kthesë në menaxhim ma të mirë të shërbimeve të veta.

- **KUR "HIDROREGJIONI JUGOR" Sh. A. Prizren**

Prodhimin e ujit të për periudhën e shikuar është ma lartë për 30,00%, ndërsa faturimi i ujit ma i ulët për 9,98%. Ndërsa, për grumbullim të ujërave të zeza kompania nuk ka dhënë të dhëna.

Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania ka prodhuar ujë ma shumë gjatë vitit 2009 për 30,52%, ndërsa, ka faturuar ma pak ujë për të njëjtën periudhë për 0.45%. Të dhënat për ujëra të zeza as kjo kompani nuk i ka ofruar.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 41,61%, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë kohore të këtij viti janë ngitë në 55,46%. Çka do të thotë se kemi një ngritje të humbjeve të ujit prej 13,86% gjatë kësaj periudhe.

Angazhimi i saj duhet të drejtohet te faturimi i të dy shërbimeve, sikurse që duhet zvogëluar dukshëm humbjet e ujit të cilat janë shumë të larta dhe mund të shkaktojnë vështirësi financiare. Mos zbatimi i kontabilitetit rregullatorë mund të krijojë vështirësi kësaj kompania për proceset e ardhshme, të cilat mund të jenë të nduarduershme.

- **KUR "BIFURKACIONI" Sh. A. Ferizaj**

Kjo kompani as një nga treguesit e planifikuar nuk i ka përmbushë gjatë periudhës së shikuar të vitit 2009. Prodhimi i ujit ka ngecë për 13,95% dhe faturimi i ujit të furnizuar po ashtu e ka ma të

ulët për 32,96%. Ndërsa, sa i parkete grumbullimit të ujërave të zeza kjo kompani ka faturuar 36,12% me pak se ato të planifikuara.

Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania ka prodhuar ma shumë ujë gjatë vitit 2009 për 38,98%, ndërsa e njëjta ka faturuar për të njëjtën periudhë të shikuar kohore ma shumë për 11,68%. Ndërsa, të dhënat për ujëra të zeza nuk i ka të deklaruar për periudhën e vitit 2008.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 të kjo kompani kanë qenë 47,50%, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë kohore të këtij viti të njëjtat janë ngritë në 57,45%. Çka do të thotë se kemi një ngritje prej 9,95%, që duhet të jetë shumë shqetësuese.

Angazhimi i saj duhet të drejtohet tek të tre treguesit për ti përmbush synimet e saja të planifikuara për këtë vit, përndryshe mund të has në vështirësi financiare. Te kjo kompani duhet theksuar se gjatë vitit të kaluar është lëshuar në punë fabrika re e përpunimit të ujit si donacion i qeverisë Zvicerane.

- **KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. Gjilan**

Prodhimin e ujit për periudhën e shikuar 9 mujore të vitit 2009 është ma i ulët se ai i planifikuar për periudhën e njëjtë për 22,20%, ndërsa edhe faturimi i ujit është po ashtu ma i ulët për 42,02%. ndërsa, për grumbullim të ujërave të zeza kompania nuk ka dhënë të dhëna të tilla.

Kur këto të dhëna i krahasojmë edhe me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania ka prodhuar ujë ma shumë gjatë vitit 2009 për 18,00% dhe po ashtu ka faturuar pak ma tepër se gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 për vetëm 2,84%. Ndërsa, të dhënat për ujëra të zeza nuk i ka të deklaruar serish.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 49,77%, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë kohore të këtij viti ato janë ngritë në 56,23%. Do të thotë se kemi një ngritje prej 6,46%.

Angazhimi i saj duhet të drejtohet në përmbushjen e planeve të prodhimit për vitin 2009. Ngecjet janë të mëdha dhe mund të këtë pasoja të mëdha për kompaninë. Edhe te kjo kompani duhet theksuar se gjatë vitit të kaluar ka lëshua në punë fabrikën e re të përpunimit të ujit si donacion i qeverisë Zvicerane.

4.1.2. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT NË NIVEL TË SEKTORIT

Prodhimi sektorial i ujit të planifikuar për periudhën e shikuar të vitit 2009 është ma i ulët për 1,57%, ndërsa edhe faturimi i ujit është ma i ulët për 17,18%. Dhe sasia e ujërave të zeza të grumbulluara është ma e vogël se ajo e planifikuar për të njëjtën periudhë për 47,72%. Për sa i përket sasisë së ujërave të zeza duhet theksuar se tri kompani nuk e kanë deklaruar të njëjtën dhe për këtë arsye mund të jetë kjo e dhënë aq negative.

Kur këto të dhëna i krahasojmë edhe me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se KRU-të kanë prodhuar ujë ma shumë gjatë vitit 2009 për vetëm 2,09%. Ndërsa, sasia e ujit të faturuar ka qenë ma e ulët në nivel të sektorit për vitin 2009 për 4,43% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2008. Për sa i përket sasisë së ujërave të zeza të grumbulluara gjatë vitit 2009 ajo është deklaruar të jetë ma e lart për 47,81% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2008.

Humbjet e ujit në nivel të sektorit gjatë vitit 2008 kanë qenë 55,52%, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë kohore të këtij viti ato **janë ngritur në 58,36%** që e bënë këtë tregues shumë negativ.


Angazhimi i të gjitha KRU-ve duhet të jetë në drejtim të përbushjes së treguesve të planifikuar të cilët kanë qenë bazë për përcaktim të tarifave të këtij viti. Ngecjet janë të mëdha dhe mund të kenë pasoja të mëdha për kompanitë.

Te humbjet e ujit duhet përmend vetëm rastin e “Radoniqit” dhe “Hidrodrinit” të cilët duket ti kenë zvogëluar humbjet të cilat nuk janë përcjellë me sasinë e prodhimit të ujit, pasi që prodhimi sipas planit të këtij vitit nuk është përbush, prandaj edhe ky tregues nuk është shumë indikativë kur bëjmë krahasimin e këtyre të dhënave për këto dy periudha kohore. Të gjitha analizat janë të bazuara në të dhënat e deklaruara prej KRU-ve.


4.1.3. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PËR UJIN E PRODHUAR DHE TË FATURUAR

Në vijim të këtij raporti pa ofruar ndonjë koment tonin po i paraqesim në mënyrë grafike të dhënat e prodhimit të ujit, shumën e faturimit veç e veç për këtë periudhë kohore për shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimit, për të gjitha KRU-të me qëllim që të shihen lëvizjet e tyre.


Diagrami Nr. 1. Prodhimi i ujit në m3



Diagrami Nr. 2. Uji i faturuar në m3



Diagrami Nr. 3. Faturimi i ujërave të zeza në m3



4.2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të vepohet sikurse ajo e të dhënave operative të prodhimit dhe faturimit të ujit. Do të analizohen ato të dhëna që kanë dallime të theksuara nga të dhënat e planifikuara dhe të aprovuara nga ZRRUM.

Tabela nr. 2 Te dhënat e shpenzimeve operative te KUR-ve									
N r. R. e...	Emritim i KUR-ve	Të dhënat e shpenzimeve operative	M të...	Kategoritë e shërbimeve					
				Ujë			Kanalizim		
				Historike	Aprovuara nga ZRRUM	Realizuar	Historike	Aprovuara nga ZRRUM	Realizuar
				9 muaj të 2008	9 muaj të 2009	9 muajt të 2009	9 muaj të 2008	9 muaj të 2009	9 muajt të 2009
1	"Prishtina" Sh.A. Prishtinë	Shpenzimet për personelin	€	1,991,627	1,181,512	1,974,375	61,711	139,226	66,853
		Shpenzimet e energjisë elektrike		1,108,792	622,928	1,412,400	6,367	-	6,916
		Shpenzimet tjera operative		1,158,531	3,516,563	961,380	4,276	215,525	11,985
		Total shpenzimet operative		4,258,950	5,321,003	4,348,155	72,354	354,750	85,754
2	"Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë	Shpenzimet për personelin	€	669,647	597,750	650,609	-	72,000	38,330
		Shpenzimet e energjisë elektrike		209,073	179,250	215,512	-	27,750	
		Shpenzimet tjera operative		498,156	460,500	439,290	-	82,500	15,537
		Total shpenzimet operative		1,376,876	1,237,500	1,305,411	-	182,250	53,867
3	"Hidrodrini" Sh.A. Pejë (të dhënat 8 mujore)	Shpenzimet për personelin	€	486,814	487,667	536,020	-	45,667	
		Shpenzimet e energjisë elektrike		143,081	100,667	162,353	-	-	
		Shpenzimet tjera operative		216,043	433,133	190,291	-	34,500	
		Total shpenzimet operative		845,938	1,021,467	888,664	-	80,167	-
4	"Radoniqi" Sh.A. Gjakovë	Shpenzimet për personelin	€	866,516	513,675	957,730	-	69,000	63,236
		Shpenzimet e energjisë elektrike		100,015	102,000	97,185	-	-	13
		Shpenzimet tjera operative		322,167	670,050	277,418	-	10,125	8,219
		Total shpenzimet operative		1,288,698	1,285,725	1,332,333	-	79,125	71,468
5	"Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren	Shpenzimet për personelin	€	545,830	497,220	720,836	-	24,170	79,289
		Shpenzimet e energjisë elektrike		247,789	229,260	316,616	-	15,660	
		Shpenzimet tjera operative		314,587	231,818	305,241	-	30,840	34,826
		Total shpenzimet operative		1,108,205	958,298	1,342,693	-	70,670	114,115
6	"Bifurkacioni" Sh.A. Ferizaj	Shpenzimet për personelin	€	279,060	94,192	201,819	-	50,911	86,494
		Shpenzimet e energjisë elektrike		18,189	12,455	22,322	-	-	
		Shpenzimet tjera operative		141,313	197,122	72,475	-	138,940	18,815
		Total shpenzimet operative		438,562	303,769	296,616	-	189,851	105,309
7	"Hidromorava" Sh.A. Jitë	Shpenzimet për personelin	€	416,560	328,875	260,214	-	82,200	
		Shpenzimet e energjisë elektrike		79,382	206,060	72,565	-	-	7,841
		Shpenzimet tjera operative		301,520	184,732	184,963	-	98,250	19
		Total shpenzimet operative		797,462	719,666	517,742	-	180,450	7,860
Shuma e shërbimeve		Shpenzimet për personelin	€	5,256,054	3,700,890	5,301,603	61,711	483,173	334,202
		Shpenzimet e energjisë elektrike		1,906,320	1,452,619	2,298,953	6,367	43,410	14,770
		Shpenzimet tjera operative		2,952,317	5,693,918	2,431,058	4,276	610,679	89,401
		Total shpenzimet operative		10,114,691	10,847,427	10,031,614	72,354	1,137,262	438,373

Në vijim po i analizojmë shkurtimisht edhe të dhënat e shpenzimeve operative për të gjitha KRU-të sipas deklarimeve të tyre dhe në fund të njëjtat po i komentojmë nga perspektiva e ZRRUM dhe eventualisht do ta nxjerrim konkluzionet për të njëjtat.

4.2.1. SHPENZIMET OPERATIVE SIPAS KRU-ve

- **KUR "PRISHTINA" Sh. A. Prishtinë**

Shpenzimet e pagave të planifikuara për shërbimet e ujit dhe kanalizimit kjo kompani për 9 mujorin e parë të këtij viti i ka tejkaluar për 54,55 %, ato të energjisë elektrike për 127,85%, ndërsa shpenzimet tjera operative janë ma të ulëta se ato të planifikuar gjatë kësaj periudhe të vitit 2009 për 73,92%.

Gjithsejtë shpenzimet operative për këtë periudhë kohore të vitit 2009 kanë qenë ma të ulëta për 21,88% nga ato te lejuara për këtë vite, ndërsa kur totalin e këtyre shpenzimeve të këtij viti e krahasojmë me të dhënat e njëjta të vitit të kaluar, të njëjtat janë ngrit për 2,37% gjatë kësaj periudhe kohore të vitit 2009.

Ngritja e shpenzimeve për paga dhe energjinë elektrike është një ngritje e madhe dhe kompania duhet të këtë parasysh këtë ngritje, sepse mund ta sjellë vet veten në vështësi financiare me pasoja. Kompania ka dështuar në realizmin e shpenzimeve tjera operative me një përqindje shumë të lartë e ky është një tregues jo i mirë se mund të shkaktohen vështirësi në shërbimet e saja nëse kështu vazhdohet edhe në të ardhmen.

- **KUR "MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë**

Shpenzimet e pagave të planifikuara për të dy shërbimet për 9 mujorin e parë të këtij viti kanë qenë ma të larta për 2,87% dhe shpenzimet e energjisë elektrike për të njëjtën periudhë janë tejkaluar për vetëm 4,11%. Ndërsa, kur krahasojmë shumën e përgjithshme të shpenzimeve operative kemi zvogëlim të tyre në raport me të dhënat e planifikuara për këtë periudhë kohore për vitin 2009 për 4,26%.

Ndërsa kur krahasojmë shpenzimet e përgjithshme operative të kësaj periudhe të vitit 2008 me të njëjtat të vitit 2009 do të shohim se kemi një zbritje të shpenzimeve të përgjithshme për 1,28%.

Nga shikimi i këtyre të dhënave duket se kompania i ka nën menaxhim të mirë dhe të mbikëqyrura grupimet e këtyre të dhënave. Shpresojmë se kjo nuk bëhet në dëm të nivelit të shërbimit. Inkurajohet kompania të vazhdojë angazhimin e vet në këtë plan.

- **KUR "Hidrodrini" Sh. A. Pejë**

Fondi i pagave për periudhën e planifikuar 8 mujore të këtij viti të cilën DFT/ZRRUM e ka marrë për analizë, kjo kompani e ka tejkaluar 2,28% e cila në krahasim me disa simotra të saja është simbolike, ndërsa në mënyrë enorme janë ngritë shpenzimet e energjisë elektrike për të njëjtën periudhë kohore dhe atë për 61,28%, e shpenzimet tjera operative kanë mbet pa u realizuar për 59,31%. Kjo ka mundësuar që kompania shumën e përgjithshme operative ta këtë ma të ulët për 12,08% për të njëjtën periudhë kohore të shikuar.

Ndërsa kur krahasohen të dhënat e njëjta të vitit 2008 me vitin 2009 për të njëjtën periudhë kohore kemi një ngritje të shumës së shpenzimeve të përgjithshme operative për 6,17% gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008.

Kompania do të vepronte mirë sikur të këtë nën kontroll ma të mirë ekuilibrimin e shpërndarjes së shpenzimeve brenda grupimeve të caktuara për të mos ulur nivelin e shërbimit. Përndryshe,

shuma e shpenzimeve është me e ulët për 12,08% se sa shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë i cili është një sinjal i mirë për këto të dhëna pa hy në elaborimin e tyre të mëtutjeshëm. Ne, shpresojmë se ulja e shpenzimeve në nivelin e planifikuar nuk ka ulur edhe nivelin e planifikuar të shërbimit për konsumatorët dhe nëse qëndron ky konstatim, kjo do të ishte një gjë pozitive sepse mundëson që këto mjete të shfrytëzohen për investime kapitale.

Kërkohet nga kompania që të mbaj të dhëna të ndara për të dy shërbimet e veta, se është e evidente se për shërbimet e kanalizimit nuk ka prezantuar as një të dhënë dhe kjo është në kundërshtim me metodën e mbajtjes së të dhënave sipas kontabilitetit rregullatorë të aprovuar dhe akorduara s'bashku.

- ***KUR "RADONIQI" Sh. A. Gjakovë***

Kjo kompani ka tejkalluar shumën e shpenzimeve të planifikuar për fondin e pagave për 9 muajt e parë të kësaj periudhe kohore të vitit 2009 për 75,22%, ndërsa shpenzimet e energjisë elektrike janë ulur për 4,71%, ndërsa shpenzimet tjera operative kanë mbet pa u realizuar për 58,01%. Ndërsa, shumën e të gjitha shpenzimeve të këtij grupimi e ka ma të larta për vetëm 2,85%.

Kur krahasohen shumat e përgjithshme të shpenzimeve operative të kësaj periudhe për vitet 2008 dhe 2009 kemi një ngritje të tyre gjatë vitit 2009 për 8,93%.

Sikurse të disa kompani të ngjashme edhe kjo është e evidente se struktura e shpenzimeve është e njëjtë duke e ngritë fondin e pagave në mënyrë enorme dhe zvogëlim të shpenzimeve tjera operative e cila mund të ndikojë në zbritjen e nivelit të shërbimeve, gjë që nuk është mirë.

Supozojmë se kompania do të këtë parasysh ekuilibrimin e këtij disproporcioni për mos krijim të kushteve për uljen e nivelit të shërbimeve. Sikurse që duhet të ketë parasysh se për këtë periudhë kohore janë tejkalluar shpenzimet e planifikuara për vitin 2009 për 2,85%, me tregues negativë për këtë periudhë kohore.

- ***KUR "HIDROREGJIONI - JUGOR" Sh. A. Prizren***

Edhe kjo kompani ka tejkalluar shumën e shpenzimeve të planifikuara për paga për 9 muajt e parë të kësaj periudhe kohore të vitit 2009 për 53,46%, ato të energjisë elektrike për 29,27%, ndërsa shpenzimet tjera operative i ka ma të larta për 29,47% dhe shumën e të gjitha shpenzimeve të planifikuara të këtij grupimi e ka ma të lartë për 41,58%.

Kur krahasohen shumat e përgjithshme të shpenzimeve operative të kësaj periudhe për vitet 2008 dhe 2009 kemi një ngritje të shpenzimeve të tilla gjatë vitit 2009 për 31,46%.

Sikurse të disa kompani të ngjashme edhe tek kjo kompani është e evidente se struktura e shpenzimeve është e njëjtë, duke i ngritë fondin e pagave dhe të energjisë elektrike në mënyrë enorme, sikurse që është ngrit te kjo kompani edhe shumën e shpenzimeve tjera operative, gjë që është rast i rrallë dhe unik në raport me kompanitë tjera.

Sipas të dhënave të prezantuara me lartë shihet qarte një tejkallim i shpenzimeve të lejuara prej 41,58% dhe nëse krahasojmë këtë vit me vitin paraprak kemi një ngritje prej 31,46%. Nga kjo del se kjo kompani është duke shfrytëzuar (është e mundur) mjetet e lejuara për investime kapitale për të mbuluar shpenzimet operative, që është një gjë shumë negative dhe do të merren masa për korrigjim të veprimeve të tilla të cilat mund të jenë me pasoja për vetë kompaninë.

- **KUR "BIFURKACIONI" Sh. A. Ferizaj**

Edhe kjo kompani ka tejkuluar shumën e shpenzimeve të planifikuara për paga për 9 muajt e parë të kësaj periudhe kohore të vitit 2009 për 12,10%.

Ndërkaq, shpenzimet e energjisë elektrike për 79,22%, ndërsa shpenzimet tjera operative i ka ma të ulëta për 65,32% dhe shumen e të gjitha shpenzimeve të këtij grupimi i ka ma të ulët për 24.57%.

Kur krahasohen shumat e përgjithshme të shpenzimeve operative të kësaj periudhe për vitet 2008 dhe 2009 kemi një ulje të tyre gjatë vitit 2009 për 8,35%, për të cilat nuk i dimë shkaqet e saja.

Sikurse te disa kompani të ngjashme edhe kjo është evidente se struktura e shpenzimeve është e njëjtë duke ngritë fondin e pagave dhe të energjisë elektrike në mënyrë enorme dhe zvogëlim të shpenzimeve tjera operative e cila mund të ndikojë në zbritjen e nivelit të shërbimeve edhe te kjo kompani, gjë që nuk do të dëshironim të ishte ashtu. Te kjo kompani duhet theksuar se planifikimi i shpenzimeve të përgjithshme nuk ka qenë adekuat dhe i drejtë, pasi që kemi zvogëlim të totalit të shpenzimeve kur krahasohen të dhënat e vitit 2008 dhe ato të vitit 2009 për periudhë të njëjtë kohore.

Mendojmë se Kompania do të duhej të kishte parasysh ekuilibrimin e këtij disproporcioni dhe mos të krijohen pasoja jo të mira për nivelin e shërbimeve dhe për vet atë.

- **KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. Gjilan**

Kjo kompani shumën e shpenzimeve të planifikuara për paga për 9 muajt e parë të kësaj periudhe kohore të vitit 2009 e ka pas ma ulët për 36,70%, ndërsa shumën e shpenzimeve të energjisë elektrike e ka tejkuluar nga shuma e planifikuar për 60,98%, dhe shpenzimet tjera operative i ka deklaruar të jenë ma të ulëta për 34,63%, ndërsa totali i të gjitha shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë kohore për këtë grupimi e ka ma të ulët për 41,61%.

Kur krahasohen shumat e përgjithshme të shpenzimeve operative të kësaj periudhe për vitet 2008 dhe 2009 kemi një zbritje për 34,09%.

Kjo kompani ka udhëheqë një politikë shumë konzervative pasi që fondin e pagave e ka deklaruar të jetë dukshëm ma e ulët nga shuma e planifikuar të shpenzimeve të tilla dhe ky është një veprim shumë i kundërt në krahasim me kompanitë tjera, edhe shpenzimet tjera operative janë dukshëm ma të ulëta për të njëjtën periudhë kohore.

Kompania do të duhej të ketë kujdes të mos ulë shpenzimet e përgjithshme operative në masën që do mund të ndikon në zbritjen e nivelit të shërbimeve, gjë që është e papranueshme për ZRRUM.

Kjo mund të na çojë te konkludimi i mundshëm se kompania me rastin e planifikimit për këtë vit kalendarik e ka mbivlerësuar shumën e shpenzimeve operative, gjë që mund të jetë me pasoja për të ardhmen, se të njëjtat i kanë ngarkuar tarifatat. Supozojmë se kompania do ti ketë parasysh ekuilibrimin e këtij disproporcioni për mos me krijuar pasoja jo të mira për nivelin e shërbimeve dhe për vet atë.

4.2.2. SHPENZIMET OPERATIVE NË NIVEL TË SEKTORIT

Shpenzimet operative sektoriale të planifikuara për periudhën e shikuar të vitit 2009 të fondit të pagave për të dy shërbimet janë ma të larta për 32,58 %, ato të energjisë elektrike për të njëjtën periudhë kohore për 54,66%. Ndërsa shpenzimet tjera operative i ka ma të ulëta për 60,02%.

Kur krahashojmë shpenzimet e përgjithshme të planifikuara në nivel të sektorit për këtë periudhë kohore të vitit 2009 të njëjtat janë **ma të ulëta se shuma e lejuar për 13,12%**.

Nëse i krahasojmë shpenzimet e përgjithshme operative të vitit të kaluar me ato të këtij viti për të njëjtën periudhë kohore shihet se të njëjtat gjatë kësaj periudhe jenë ma të larta për vetëm 0,62%.


Me përjashtime të caktuara kompanitë duhet të përqendrohen në balancimin e shpenzimeve të veta nga një grupim te tjetri.

Është evidente se fondet e pagave të shumica e kompanive është tejkaluar dukshëm, sikurse që janë tejkaluar dhe shpenzimet për energjinë elektrike. Duket se këto grupime të shpenzimeve janë ngritë në dëm të shpenzimeve tjera operative, gjë që mund të jetë me rrezik të theksuar për zvogëlim të nivelit të shërbimit në kuadër të cilave hynë edhe funksionaliteti teknik i sistemeve të ujësjellësve dhe kanalizimeve.


4.2.3. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PËR SHPENZIME OPERATIVE PËR KRU-TË

Edhe këto të dhëna po i paraqesim në mënyrë grafike për çdo kompani veç e veç, me qëllim që të shihen lëvizjet e tyre.

Diagrami Nr. 4 Shpenzimet operative për shërbimet e ujësjellësit



Diagrami Nr. 5 Shpenzimet operative për shërbimet e kanalizimit



4.3. ANALIZA E FATURIMIT DHE INKASIMIT

Me të dhënat e faturimit dhe inkasimit kompletohet në një masë pasqyra e të dhënave kryesore operative dhe financiare të deklaruara nga KRU-të për periudhën 9 mujore të këtij viti. Prandaj, në vijim po i prezantojmë të dhënat periodike për shumën e faturimit të çdo kompanie veç e veç dhe shkallën e inkasimit për të njëjtat, të përmbledhura për të dy shërbimet në një të dhënë (ujësjellës dhe kanalizim), për të cilat do jipen komentet për çdo njëri prej tyre, duke i përmbledhë pastaj të dhënat për sektorin si tërësi me konkluzione të shkurta për të njëjtat.

Tabela Nr. 3 Të dhënat për faturimin dhe inkasimin

Nr. Rendi	Emrtimi i KUR-ve dhe Lokacioni	Të dhënat operative	Njësia	Kategoritë e shërbimeve					
				Ujë			Kanalizim		
				Historike	Aprovuara nga ZRRUM	Realizuar	Historike	Aprovuara nga ZRRUM	Realizuar
				9 muaj të 2008	9 muaj të 2009	9 muajt të 2009	9 muaj të 2008	9 muaj të 2009	9 muajt të 2009
1	"Prishtina" Sh.A. Prishtinë	Faturimi	€	6,174,858	7,823,108	6,906,902	685,970	798,744	487,760
		Inkasimi	€	4,086,041	5,685,504	4,513,057	454,004	575,252	
2	"Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë	Faturimi	€	1,449,827	1,529,438	1,580,026	-	269,438	78,520
		Inkasimi	€	930,755	882,739	882,704	-	183,882	-
3	"Hidrodriini" Sh.A. Pejë (Të dhënat 8 mujore)	Faturimi	€	1,516,698	1,432,086	1,578,278	-	195,796	175,352
		Inkasimi	€	1,074,482	1,004,026	961,790	-	131,374	-
4	"Radoniqi" Sh.A. Gjakovë	Faturimi	€	1,846,357	2,389,918	1,456,139	-	255,906	159,913
		Inkasimi	€	1,382,756	1,837,573	1,352,028	-	218,870	
5	"Hidroregjijoni Jugor" Sh.A. Prizren	Faturimi	€	1,429,350	1,459,736	1,807,344	-	220,760	212,882
		Inkasimi	€	993,931	1,040,475	1,208,498	-	157,131	
6	"Bifurkacioni" Sh.A. Ferizaj	Faturimi	€	651,024	813,708	580,768	-	229,851	190,248
		Inkasimi	€	367,956	541,592	370,109	-	151,528	78,520
7	"Hidromorava" Sh.A. Gjilan	Faturimi	€	835,367	965,735	684,007	-	214,111	144,219
		Inkasimi	€	744,687	738,113	617,893	-	161,844	
Sasia e përgjithme		Faturimi	€	13,903,481	16,413,728	14,593,464	685,970	2,184,605	1,448,894
		Inkasimi	€	9,580,608	11,730,023	9,906,079	454,004	1,579,880	78,520

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të veprojmë sikurse kemi vepruar te të dhënat operative. Do të analizohen ato të dhëna që kanë dallime të theksuara nga të dhënat e planifikuara dhe të aprovuara nga ZRRUM.

4.3.1. FATURIMI DHE INKASIMI SIPAS KRU-ve

- **KUR "PRISHTINA" Sh. A. Prishtinë**

Planifikimi i faturimit dhe inkasimit të kjo kompani gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 ka qenë shumë ambiciozë dhe kjo mund të shihet se për 9 muajt e parë të këtij viti e njëjta ka planifikuar të ngrit shumën e faturimit për vitin 2009 për 25,67% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2008, sikurse që ka planifikuar edhe ngritjen e shumës së inkasimit për të njëjtën periudhë për 37,90%. Synimet e tilla kompania nuk ka mund ti realizoj as për së afërmi.

Por, kur krahasohen të dhënat e planifikuara dhe të realizuara për faturim dhe inkasim për 9 muajt e parë të vitit 2009 kemi mos realizim të planit të faturimit për 14,23% dhe te inkasimit për 27,92%. Nëse i krahasojmë këto të dhëna me periudhën e njëjta kohore të vitit 2008 dhe atë të vitit 2009 do të shohim se kemi ngritje të shkallës së faturimit 7,78% dhe inkasimit 0,59%.

Duke parë gjendjen ekzistuese, kompania duhet të angazhohet me i përmbush parametrat e planifikuara për këtë vit pasi që të njëjtit kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në tarifën ekzistuese. Këtë e theksojmë edhe për arsye se vet ngritja e tarifës ka ndikuar në ngritjen e shumës së faturimit, pasi që tarifa e shërbimit për ujë dhe kanalizim të konsumatorët shtëpiakë gjatë vitit 2009 është ngritë për 10,00%, ndërsa e njëjta për konsumatorët jo-shtëpiakë për të njëjtën periudhë është ngritë për 21,54%. Për sa i përket shërbimeve të kanalizimit të konsumatorët shtëpiakë kemi një zbritje të tarifës nga 0,05€/m³ në 0,03€/m³, ndërsa për jo-shtëpiakët e njëjta është ngritë nga 0,05€/m³ në 0,07€/m³.

Kur kemi parasysh proporcionin e këtyre dy tarifave është evidente se nuk ka ndonjë tregues shpresëdhënës për këtë vit, nëse nuk kemi përmirësime të theksuara gjatë muajve të ardhshëm të këtij viti afarist.

- **KUR "MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë**

Edhe kjo kompani sikurse te KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë. ka planifikuar një ngritje të shkallës së faturimit dhe inkasimit gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008. Kjo kompani ka qenë ma realist dhe kjo mund të shihet se për 9 muajt e parë të këtij viti e njëjta ka planifikuar të ngrit shumën e faturimit për vitin 2009 për 24,08% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2008, sikurse që ka planifikuar edhe zbritjen e shumës së inkasimit për të njëjtën periudhë për 18,59%. Që të dy këto të dhëna nuk janë përmbush e sidomos shkalla e inkasimit.

Por, kur krahasohen të dhënat e planifikuara dhe të realizuara për faturim dhe inkasim për 9 muajt e parë të vitit 2009 kemi mosrealizim të planit të faturimit për 7,80%, dhe poashtu mos realizim edhe te shumës së inkasimit për 17,24%. Nëse i krahasojmë arritjet e Kompanisë lidhur me këta dy tregues për vitin 2008 me vitin 2009 për të njëjtën periudhë kohore (9 muaj) shohim se kemi ngritje të shkallës së faturimit 14,40% dhe rënie të shkallës së inkasimit për 10,49%.

Duke parë gjendjen ekzistuese, kompania duhet të angazhohet me i përmbush parametrat e planifikuar pasi që të dhënat e këtilla të dala kanë ndikim të drejtpërsëdrejti në tarifën këtij viti, duke marrë parasysh se tarifa e kombinuar e shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimit të konsumatorët shtëpiakë është ngrit për 6,45%, për te jo shtëpiakë për 18,57%. Ndërsa po

tregojmë vlerën absolute të lëvizjes së tarifës së shërbimit të kanalizimit të konsumatorët jo-shtëpiakë e cila është ngritë nga 0,05€/m³ në 0,13€/m³, ndërsa për këtë shërbim kjo tarifë të konsumatorët shtëpiakë për vitin 2009 ka mbet si ajo e vitit 2008.

Kur kemi parasysh proporcionin e tarifës së ujit është evidente se nuk ka ndonjë përmirësim të theksuar të gjendjes, nëse e njëjta nuk tejkalohet gjatë periudhës së ardhshme tre mujore të këtij viti afarist.

- **KUR "Hidrodrini" Sh. A. Pejë**

Kjo kompani ka qenë shumë ma e përmbytur në planet e veta për këtë vit afarist dhe kjo shihet edhe në këtë rast, pasi që shumën e faturimit për vitin 2009 e ka planifikuar se do ta ngritë për 7,33% dhe atë të inkasimit për 5,67% për 8 muajt e parë të këtij viti, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Edhe për kundër faktit se kjo kompani ka qenë më modeste në planet e saja për këtë vit për sa i përket shumës së faturimit dhe asaj të inkasimit, prapë se prapë e njëjta ka dështuar që ti përmbush synimet e veta planifikuara, ato të shërbimit të ujit për 8 muaj në krahasim me planin, sepse kemi faturim ma të larte për 7,72%, por kemi një ulje të shkallës së inkasimit prej 15,29%. Prandaj, kjo kompani duhet të angazhohet shumë më tepër sa i përket ngritjes së inkasimit duke pasur parasysh se kemi një ngritje të faturimit që është një gjë pozitive. Kompania njërin nga treguesit e ka negativ edhe në krahasim me vitin e kaluar. Nëse e krahasojmë faturimin dhe inkasimin gjatë dy periudhave të njëjta kohore të vitit 2008 dhe 2009, pasi që shumën e faturimit e kemi me të larte për 15,62% dhe atë të inkasimit ma të ulët 10,49%.

Duke parë gjendjen ekzistuese, kompania duhet të angazhohet me i përmbush parametrat e planifikuar pasi që edhe përkundër ngritjes ma të përmbytur të planeve të faturimit dhe inkasimit, të dhënat e realizuara për 8 muajt e parë të këtij viti nuk janë shumë shpresëdhënës.

Te kjo kompani kemi pas ngritje të përmbytur të tri tarifave të cilat kanë ndikuar në ngritjen edhe të shumës së faturimit. Tarifa për shërbimet e ujit të konsumatorët shtëpiakë është ngritë vetëm 4,76%, ndërsa tarifa për shërbimet e kanalizimit të jo-shtëpiakët për 40,00% ose nga 0,05 në 0,07 €/m³, sikurse që është ngritë edhe tarifa fikse për konsumatorët jo-shtëpiakë nga 2,00 në 3,00 €/muaj, në krahasim me vitin paraprak 2008.

Është evidente se kompania ka dështuar me i përmbush pothuajse që të gjithë treguesit e planifikuar të këtij viti.

- **KUR "RADONIQI" Sh. A. Gjakovë**

Edhe kjo kompani në planet e veta të këtij viti ka synuar ngritje të theksuara të shumave të faturimit dhe inkasimit për 9 muajt e këtij viti, nga ku del të ketë qenë larg nga realiteti i tanishëm. "Radonqi" ka planifikuar një ngritje të shumës së faturimit dhe inkasimit gjatë kësaj periudhe të vitit 2009 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, dhe atë; shuma e faturimit të planifikuar gjatë vitit 2009 është paramenduar të jetë ma e lartë për 43,30% dhe ajo e inkasimit për 48,72% në krahasim me vitin 2008. Që të dy këto të dhëna janë larg nga përmbushja e tyre.

Por, kur krahasohen të dhënat e planifikuara dhe të realizuara për faturim dhe inkasim për 9 muajt e parë të vitit 2009, kemi mos realizim të planit të faturimit për të dy shërbimet, dhe atë; për faturim 38,92% dhe për inkasimit për 34,25%.

Nëse këto të dhëna i krahasojmë për periudhat e njëjta të viteve 2008 dhe 2009 do të shohim se as këto të dhëna nuk janë pozitive, dhe atë; shumën e faturimit e kemi ma të ulët për 12,47% dhe për shumën e inkasimit për 2,22%.

Duke parë gjendjen ekzistuese edhe kjo kompani duhet me u angazhua shumë më tepër në përmbushjen e parametrave të planifikuar për vitin 2009, pasi që edhe në këtë rast kemi pas ngritje të tri tarifave për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008, të cilat kanë ndikuar sado pak në ngritjen e shumave të faturimit dhe inkasimit të këtij viti.

Nëse shikohet nga ky prizëm edhe efektet janë më të pa favorshme. Kompanisë i duhet angazhim shumë ma i madh për të zënë hapin e humbur për shërbimet që i ofron.

- ***KUR "HIDROREGJIONI - JUGOR" Sh. A. Prizren***

Rasti i kësaj kompanie është pak ma specifik, pasi që e njëjta ka qenë ma e përmbajtur në planet e veta për këtë viti afarist dhe kjo shihet nga krahasimi që u janë bërë grupimit të dhënave të shumave të faturimit dhe inkasimit mes viteve 2008 dhe 2009, për 9 muajt e parë të këtij viti. Me planin e vitit 2009 ishte planifikuar se faturimi do të ngritet për 17,57% dhe inkasimi për 20,49%.

Por, kur krahasohen të dhënat e planifikuara dhe të realizuara për faturim dhe inkasim për 9 muajt e parë të vitit 2009, kemi mos realizim të planit të faturimit për të dy shërbimet, dhe atë; për faturim 9,84% dhe për inkasimit për 0,91%.

Nëse krahasohen të dhënat e realizuar për 9 muajt e vitit 2008 me ata të njëjtës periudhë të vitit 2009 do të shohim se kemi ngritë shumën e faturimit gjatë vitit 2009 për 6,00% dhe të inkasimit për 21,59%. Edhe të dhënat e kësaj kompanie janë të ndikuara në masë të madhe nga ngritja e katër tarifave të shërbimit për këtë vit dhe një zbritje simbolike e tarifës për shërb. e kanalizimit.

Inkurajohet kompania të vazhdojë në këtë drejtim edhe gjatë muajve ne vijim të këtij vitit afarist.

- ***KUR "BIFURKACIONI" Sh. A. Ferizaj***

Edhe kjo kompani ka qenë ambicioze me rastin e planifikimit të dhënave të veta për vitin 2009, kur ato krahasohen me vitin 2008. Kjo shihet nga krahasimi që u janë bërë grupimit të dhënave të shumës së faturimit dhe inkasimit për vitin 2008 dhe vitin 2009, të cilat janë përpunuar për 9 muajt e parë të këtij viti, pasi që shuma e faturimit ishte planifikuar se do të jetë ma e lartë për 60,30% dhe inkasimit për 88,37%.

Kompania shumën e planifikuar të faturimit për 9 muajt e parë të këtij viti ka dështuar ta përmbush për 26,12% dhe atë të inkasimit për 35,27%. Këta dy tregues janë jashtëzakonisht të disfavorshëm. Kjo kompani që të gjithë treguesit e planifikuar për vitin 2009 i ka negativë dhe të njëjtit ishin larg nga përmbushja e tyre për këtë periudhë shikuar kohore.

Kur krahasohen të dhënat e planifikuara të viteve 2008 dhe atë të vitit 2009 për shumat realizuara për faturim dhe inkasim për të njëjtën periudhë 9 mujore, shohim se në raport me të dhënat e të njëjtës periudhë të vitit 2008 kemi të dhëna pozitiveve, dhe atë: te faturimi për 18,43% dhe atë të inkasimit për 21,92%, çka do të thotë se kompania ka arrite një ndryshim te vogel ne krahasim me vitin e kaluar. Kjo është e mjaftueshme kur te kihet parasysh se te kjo kompani ka pas nje ngritje te tarifës per te dy shërbimet e kanalizimit për vitin 2009.

Me qellim të realizimit të synimeve të veta "Bifurkacioni" duhet të bëjë përpjekje shtesë për të përmirësuar këtë gjendje, përndryshe mund të këtë vështirësi në afarizmin e saj.

- **KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. Gjilan**

Edhe te kjo kompani të dhënat analizohen për 9 muajt e parë të këtij viti të cilat dëshmojnë për qasje jo të bazuar të planifikimit i cili ka qenë tejet ambicioze për vitin 2009, kur ato krahasohen me të dhënat e vitit 2008. Ky konkludim vjen nga fakti se shumat e faturimit dhe inkasimit për vitin 2009 janë planifikuar të jenë ma të larta; për faturim 41,24% dhe ato për inkasim 20,85% , në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Kompania shumat e planifikuar të faturimit dhe inkasimit për vitin 2009 për të njëjtën periudhë të këtij viti ka dështuar ta përmbush, te faturimi për 29,80% dhe atë të inkasimit për 31,34%. Edhe kjo kompani që të gjithë treguesit e planifikuar për vitin 2009 i ka negativë dhe është larg nga përmbushja e tyre për këtë periudhë kohore.

Kur krahasohen të dhënat e planifikuara të viteve 2008 dhe atë të vitit 2009 për shumat realizuara për faturim dhe inkasim për njëjtat periudhën 9 mujore, shohim se edhe në raport me të dhënat e të njëjtës periudhë të vitit 2008 kemi të dhëna negative, dhe atë: faturimi është ma i ulët për 0,85% dhe inkasimi për 17,03%, çka do të thotë se kompania ka dështuar me e realizuar edhe planin e vitit 2008 e lërë më atë të vitit 2009. Edhe te kjo kompani kemi pas ngritje të theksuar të pesë tarifave, dhe atë; te konsumatorë shtëpiakë për dy tarifa (ujë dhe kanalizim) kemi pas ngritje prej 16,67% dhe të konsumatorët jo-institucional për të dy tarifa (ujë dhe kanalizim) kemi pas ngritje prej 27,27% dhe atë të tarifës fikse nga 2,00 – në 3,00 €/muaj për konsumatorët jo-shtëpiakë për vitin 2009.

Me qellim të realizimit të synimeve të veta edhe kjo kompani duhet të bëjë përpjekje shtesë për të përmirësuar këtë gjendje përndryshe mund të këtë vështirësi në afarizmin e saj.

4.3.2. FATURIMI DHE INKASIMI NË NIVEL TË SEKTORIT

Fillimisht do të shikojmë dhe bëjmë krahasimet e nevojshme sektoriale në mes të shumave të faturimit dhe të inkasimit për periudhat e shikuara kohore të vitit 2008 dhe atë të së njëjtës periudhë të vitit 2009. Planifikimet e kompanive kanë qenë shumë ambicioze për këto të dhëna për vitin 2009 dhe si të tilla duhet thënë me një përjashtim kanë mbet larg nga realizimi i tyre. Kjo për faktin se është planifikuar një ngritje e shumë të faturimit gjatë vitit 2009 për 25,81% dhe inkasimit për 29,83% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2008.

Të dhënat sektoriale tregojnë se shuma e faturimit ka qenë më e ulët se sa shuma e planifikuar për këtë periudhë kohore për vitin 2009 për 14,03%. Ndërsa shuma e inkasimit ka qenë edhe ma e ulët se shuma e planifikuar për të njëjtën periudhë kohore për 24,98%.

Këto të dhëna na tregojnë se gjatë kësaj periudhe kohore të vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 është: (i) **tejkalar faturimi për 8,52%**, ndërsa (ii) inkasimi është **më i ulët për 6,08%**. Që të dy këta tregues janë shumë larg nga caqet e planifikuara për tu përmbushë.


Ngritjet e tilla janë më dekurajuese edhe për faktin se që të gjitha janë ndikuar nga ngritjet e tarifave në sektorë, diku ma tepër e diku ma pak dhe sikurse këto ngritje të mos ishin bërë treguesit e tillë do të ishin edhe më të disfavorshëm.

Për ta ndryshuar këtë gjendje KRU-të duhet të angazhohen për të përmirësuar performancën e vetë, përndryshe reperkusionet janë të pa evitueshme se në to kanë ndikuar tarifatat e këtij viti.


4.3.3. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE TË FATURIMIT DHE INKASIMIT

Të dhëna për faturimin dhe inkasimin janë paraqitur mënyrë grafike për çdo kompani veç e veç.


Diagrami Nr. 5 - Të hyrat e faturuara nga uji




Diagrami Nr. 6 - Të hyrat e inkasuara nga uji



Diagrami Nr. 7 - Të hyrat e faturuara nga ujërat e zeza



Diagrami Nr. 8 Të hyrat e inkasuara nga ujërat e zeza



4.4. ANALIZA E INVESTIMEVE KAPITALE

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të veprojmë sikurse kemi vepruar te të dhënat tjera të përshkruara më lartë. Të njëjtat do të pasqyrohen për 9 mujorin e parë të vitit 2008 dhe për të njëjtën periudhë të vitit 2009, për çdo kompani veç e veç, pastaj shumat e investimeve të lejuara nga rregullatori dhe ndaras ato të realizuara për periudhën e shikuar 9 mujore të vitit 2009.

Të dhënat e pasqyruar në Tabelën Nr. 4., janë të kategorizuara për dy llojet të shërbimeve; shërbimet e ujësjellësit dhe shërbimet e kanalizimit, të cilat janë ndarë në asetet infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore, pastaj të njëjtat janë definuar edhe për kah forma e planifikuar e financimit, në investime vetjake dhe nga donatorët potencial.

Pas këtyre kategorizimeve DFT/ZRRUIM për vitin 2009 ka bërë edhe këto pasqyrime, si shumën e projekteve të planifikuara dhe aprovuara nga KRU-të dhe të lejuara nga ZRRUM për realizim nga burimet vetjake të financimit dhe shumën e projekteve të realizuar për këtë periudhë kohore nga ky burim, sikurse që është bërë përshkrim i njëjtë edhe shumën e projekteve të financuara nga donatorët.

Të dhënat e tilla do të analizohen shkurtimisht dhe do të komentohen me qëllim të ndërmarrjes së masave për përmirësim të gjendjes ekzistuese të shumica e kompanive, pasi që kjo është e evidente se treguesit nuk janë të mirë për këtë periudhë të shikuar.

Edhe këto të dhëna po i paraqesim në formë tabelore me qëllim të krahasimit më të lehtë të të dhënave të tilla të marra nga kompanitë dhe si zakonisht të njëjtat do të përmbledhen dhe trajtohen si të dhëna të sektorit si tërësi.

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të veprojmë sikurse kemi vepruar me të dhënat tjera. Të njëjtat do të analizohen, komentohen dhe shkurtimisht do të nxirren konkluzione me synim të përmirësimit të kësaj gjendje në muajt dhe vitet e ardhshme të vlefshmërisë së këtij procesi rregullatorëve (2009 -2011).

Tabela Nr.4 Investimet kapitale të planifikuara, të lejuara nga DFT/ZRRUM dhe të realizuara nga kompanit për 9 muajt e parë të procesit tarifor 2009 në €

Emri i Kompanisë	Kategoria e Investimeve	Investimet Kapitale për Ujë			Investimet kapitale për Kanalizim			Shuma e Investimeve të planifikuara nga kompania për 2009	Shuma e Investimeve vetanake të lejuara me tarifen e vitit 2009	Projektet e realizuara në 9 mujorin e parë të vitit 2009	
		Vetanake	Donacione	Totali	Vetanake	Donacione	Totali			Vetanake	Donacione
"Prishtina" Sh.A. Prishtinë	Infrastrukturë	1,159,600	6,629,000	7,788,600	152,000	-	152,000	7,940,600	1,679,746	117,053	31,167
	Jo-Infrastrukturë	1,315,800	7,840,000	9,155,800	216,900	1,698,200	1,915,100	11,070,900			
	Totali	2,475,400	14,469,000	16,944,400	368,900	1,698,200	2,067,100	19,011,500			
"Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë	Infrastrukturë	210,850	312,800	523,650	8,700	71,700	80,400	604,050	268,132	-	445,898
	Jo-Infrastrukturë	512,100	139,000	651,100	9,300	-	9,300	660,400			
	Totali	722,950	451,800	1,174,750	18,000	71,700	89,700	1,264,450			
"Hidrodrini" Sh.A. Pejë	Infrastrukturë	452,000	410,000	862,000	19,000	-	19,000	881,000	352,766	66,614	760
	Jo-Infrastrukturë	170,500	60,000	230,500	15,000	-	15,000	245,500			
	Totali	622,500	470,000	1,092,500	34,000	-	34,000	1,126,500			
"Hidrosistemi Radoniqi" Sh.A. Gjakovë	Infrastrukturë	133,000	252,000	385,000	57,675	376,700	434,375	819,375	957,050	17,559	-
	Jo-Infrastrukturë	600,000	1,650,000	2,250,000	-	-	-	2,250,000			
	Totali	733,000	1,902,000	2,635,000	57,675	376,700	434,375	3,069,375			
"Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren	Infrastrukturë	260,800	1,555,894	1,816,694	197,200	5,250,000	5,447,200	7,263,894	383,810	91,917	179,000
	Jo-Infrastrukturë	244,800	1,500,332	1,745,132	50,000	5,000,000	5,050,000	6,795,132			
	Totali	505,600	3,056,226	3,561,826	247,200	10,250,000	10,497,200	14,059,026			
"Bifurkacioni" Sh.A. Ferizaj	Infrastrukturë	492,000	425,000	917,000	218,800	-	218,800	1,135,800	663,012	47,434	964,587
	Jo-Infrastrukturë	252,000	-	252,000	43,200	-	43,200	295,200			
	Totali	744,000	425,000	1,169,000	262,000	-	262,000	1,431,000			
"Hidromorava" Sh.A. Gjilan	Infrastrukturë	25,000	390,000	415,000	25,000	-	25,000	440,000	93,016	-	72,974
	Jo-Infrastrukturë	332,600	180,000	512,600	-	-	-	512,600			
	Totali	357,600	570,000	927,600	25,000	-	25,000	952,600			
Totali i investimeve		6,161,050	21,344,026	27,505,076	1,012,775	12,396,600	13,409,375	40,914,451	4,397,531	340,576	1,484,218

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të veprimë sikurse kemi vepruar te të dhënat operative dhe financiare. Do të analizohen ato të dhëna që kanë dallime të theksuara nga të dhënat e planifikuara dhe të aprovuara nga DFT/ZRRUM.

- **KUR "PRISHTINA" Sh. A. Prishtinë**

Kjo kompani ka planifikuar një numër të madh të projekteve me shuma të mëdha të investimeve kapitale për tu realizuar gjatë vitit 2009, si nga mjetet vetanake të financimit të investimeve, po ashtu edhe ato nga donatorët. Mirëpo në mungesë të mbylljes së konstruksionit financiarë të njëjtat kanë mbet vetëm projekte ekzistuese të cilat priten të realizohen në periudha ma të mira kohore të afarizmit të kësaj kompanie dhe të mjedisit rrethues të saj.

ZRRUM me tarifat e këtij viti ka lejuar një shumë dukshëm ma të vogël të investimeve për të dy shërbimet nga burimet vetjake të cilat i kanë ngarkuar tarifat e këtij viti, e cila shprehur në % do të mund të arrinte shumën prej 59,06% të shumës së planifikuar për vitin 2009, nëse përmbushen parametrat e planifikuar të këtij viti afarist të inkorporuar në procesin e përcaktimit të tarifave.

Por këto plane janë larg nga realizimi i tyre, pasi që për këta 9 muajt e kaluar nga mjetet vetanake të investimeve ato janë realizuar vetëm për 6,97%. Ndërsa shuma e vetme e investimeve të realizuara nga donatorët gjatë kësaj periudhe kohore është 31.167 € e cila është e pa përfillshme.

Kompania duhet të angazhohet për realizim të shumës së investimeve të lejuar për këtë vit se do të ngecë me zgjerim të bazës së vet fizike dhe financiare dhe në këtë formë vjen do të vij deri te ulja e vlerës financiare të aseteve dhe mund të ndeshet me faktin e zbritjes së tarifës së vitit 2010 edhe për atë shumë të investimit të pa realizuar nga investimet vetanake.

- **KUR "MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë**

Edhe kjo kompani ka planifikuar një shumë relativisht të lartë të investimeve për tu realizuar gjatë vitit 2009 për kushtet e veta, si nga mjetet e veta financiare po ashtu edhe nga ato të donatorëve të mundshëm. Duke analizuar rrethanat e përgjithshme, rregullatori për këtë kompani ka lejuar vetëm 36,19% të shumës së planifikuar të investimeve të veta nga burimet vetanake financiare për të dy shërbimet për vitin 2009 të cilat do të mund të mbuloreshin nga tarifat e këtij viti, nëse përmbushen të gjithë parametrat e planifikuar për këtë vit.

Nga verifikimi i të dhënave është dëshmuar se e njëjta nuk ka realizuar as një shumë të investimeve nga burimet vetanake të investimeve gjatë periudhës së shikuar 9 mujore të këtij viti.

Nga donacionet, kjo kompani ka deklaruar se për këtë periudhe kohore ka realizuar një vlerë te konsiderueshme të investimeve me financim në formë grantesh dhe ajo arrin vlerën prej 445.898 € e cila në përqindje e ngrit shkallen e projekteve të realizuar nga donatorët në lartësi prej 85,18% të mjeteve të planifikuara për këtë vit.

Rasti i kësaj kompanie për sa u përket donacioneve është më specifik në krahasim me kompanitë tjera. Edhe te kjo kompani vlen përkrahimi i dhënë për KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë.

- **KUR "Hidrodrini" Sh. A. Pejë**

Edhe "Hidrodrini" ka planifikuar një numër të caktuar të projekteve me shuma relativisht të lartë të investimeve për tu realizuar gjatë vitit 2009, si nga mjetet vetanake të investimeve, po ashtu edhe nga ato të donatorëve të mundshëm. Mirëpo në mungesë të mbylljes së konstruksionit financiarë, DFT/ZRRUM me tarifatat e këtij viti ka lejuar një shumë dukshëm ma të vogël të investimeve nga burimet vetanake e cila mund të realizohet nëse përmbushen parametrat operativë financiarë të këtij viti.

Shuma e investimeve të lejuara për realizim shprehur në % do të mund të arrijnë shumën e tërësishme të planifikuar të vitit 2009 prej 53,73% e cila për këtë periudhë të shikuar është realizuar vetëm për 18,88% për këtë 8 muajt e parë të vitit 2009. Ndërsa projektet e planifikuara për tu realizuar nga donatorët mund të thuhet se nuk është realizuar as një, përveç shumës minore prej 760,00 €.

Kompania duhet të angazhohet për realizim të shumës së investimeve të lejuar për vitin 2009 se do të ngecë me zgjerim të bazës së vet të aseteve dhe mund të ndeshet me faktin e zbritjes së tarifës së vitit 2010 edhe për atë shumë të investimet të pa realizuara nga investimet vetanake që kanë ndikuar në ngritjen e tarifave.

- **KUR "RADONIQI" Sh. A. Gjakovë**

Edhe kjo kompani ka planifikuar një numër të caktuar të projekteve me shumë relativisht të lartë të investimeve për mundësitë e veta gjatë vitit 2009, si nga mjetet vetanake të investimeve po ashtu edhe nga donatorët e mundshëm. Rasti i kësaj kompanie është më specifik ngase kompania kishte planifikuar investime ma të pakët në shumë nga burimet vetanake dhe rregullatori të njëjtën e ka ngritë për 21,04%, pas korrigjimeve të bëra të tarifave dhe në të njëjtën kohë është kërkuar që e njëjta fitimin e mbetur ta përdorë për investime kapitale.

Nga shuma e lejuar për investime prej 957.050,00 €, kompania për 9 muajt e parë të këtij viti ka realizuar vetëm 17.559,00€ ose shprehur në % vetëm 1,83%. Edhe te kjo kompani projektet investimeve vetanake mund të realizohen vetëm nëse përmbushen parametrat e planifikuar për këtë vit në masën 100%, gjë që nuk është rasti gjer me tani.

Ndërsa, projektet e planifikuara për tu realizuar nga donatorët e mundshëm nuk janë filluar ende e as që ka ndonjë të realizuar gjatë kësaj periudhe kohore.

Edhe kjo kompani duhet të angazhohet për realizim të shumës së investimeve të lejuar për vitin 2009 se do të ngecë me zgjerim të bazës së vet të aseteve dhe zvogëlim të vlerës së vet financiare të aseteve vetanake dhe mund të ndeshet me faktin e zbritjes së tarifës së vitit 2010 edhe për atë shumë të investimet të pa realizuara nga burimet e veta të financimit.

- **KUR "HIDROREGJIONI - JUGOR" Sh. A. Prizren**

KUR "Hidroregjioni-Jugor" Sh. A. Prizren, kishte planifikuar numër të caktuar të projekteve me shuma të caktuar të investimeve kapitale për tu realizuar gjatë vitit 2009, si nga mjetet vetanake të investimeve, po ashtu edhe nga donatorët potencial.

Mirëpo në mungesë të mbylljes së konstruksionit financiarë, DFT/ZRRUM me tarifatat e këtij viti ka lejuar një shumë dukshëm ma të vogël të investimeve nga burimet vetanake e cila

shprehur në % do të mund të arrinte shumën e investimeve të planifikuara të viti 2009 prej 50,98% dhe nga kjo shumë e lejuar kompania ka realizuar shumën e investimeve për vetëm 23,95% për 9 muajt e parë të këtij viti. Ndërsa nga shuma e projekteve të planifikuara për realizim nga donatorët gjatë vitit 2009 prej rreth 13,00 miliona Euro e njëjta ka realizuar vetëm 179.000 €, ose shprehur në % kjo kompani ka realizuar investime të financuara nga donatorët për këta 9 muaj vetëm 1,35% e cila shumë është e papërfillshme.

Edhe për këtë kompani mund ti përshkruhet konkluzionet e theksuar si për kompanitë tjera.

- ***KUR "BIFURKACIONI" Sh. A. Ferizaj***

Edhe kjo kompani ka planifikuar një numër të caktuar të projekteve me shumë të caktuara të investimeve për ti realizuar gjatë vitit 2009, si nga mjetet vetanake të investimeve po ashtu edhe ato nga donatorët e mundshëm. Projektet e planifikuara për realizim nga mjetet vetanak janë ma të shumta në shumë se ato të donatorëve të mundshëm. Kompanisë nuk i është lejuar shuma e kërkuar për financime nga mjetet vetanake, pasi që ajo nuk do të mund të realizojë të njëjtat me tarifën e shërbimit për këtë vit kalendarik. Por nga shuma e investimeve të planifikuara të njëjtës i është lejuar shuma e kërkuar për 65,91% që është rast i rrallë me një % kaq të lartë dhe nga kjo shumë e njëjta ka realizuar një shumë minore e cila shprehur në % është vetëm 7,15% e cila është e pa përfillshme.

Ndërsa nga projektet e planifikuara për tu realizuar nga donatorët e mundshëm për vitin 2009 e njëjta ka planifikuar të realizojë vlerën e projekteve prej 425.000 €, sipas të dhënave të muajve janar – shtator 2009 e njëjta ka prezantuar të dhëna për projekte të realizuar në shumë prej 232,111.75€, që shprehur në (%) del të jetë realizuar 35%.

Një gjë e cila duhet të sqarohet kompania është fakti se e njëjta me rastin e monitorimit të dhënave të para të periudhës janar-maj 2009 për Raportin e Parë periodik kishte deklaruar se ka realizuar projekte investive për këta 5 muaj në shumë prej 1.032.371,00 € e tani kjo del të mos jetë e sakët, është i domosdoshëm sqarim për këtë.

Prandaj kërkohet nga kompania që ti sqarohet këto të dhëna me rastin e marrjes së këtij raport, pasi që ajo ka deklaruar vet se ka realizuar një numër të madh të projekteve fal përkrahjes së Kuvendit Komunal i cili ka bërë riparime dhe ndërrim të gypave të ujësjellësit dhe kanalizimit në qytet dhe lokalitete tjera dhe dimensione të caktuara.

Problem në vete për kompaninë është mos realizimi i projekteve investive nga burimet e brendshme financiare. Me mos realizimin e projekteve të tilla investive me shumën e investimeve të lejuar nga DFT/ZRRUM, kompania nuk e zgjeron bazën e vet fizike të aseteve dhe e zvogëlon vlerën financiare të tyre, vit pas viti dhe mund të ndeshet me faktin e zbritjes së tarifës së vitit 2010 edhe për atë shumë të investimeve të pa realizuara e të lejuara nga rregullatori nga burimet e veta financiare.

- ***KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. Gjilan***

KUR "Hidromorava" Sh. A. Gjilan, ka planifikuar një numër të caktuar të projekteve investive për tu realizuar gjatë vitit 2009, nga mjetet financiare vetanake dhe nga ato të donatorëve potencial. Kësaj kompanie nga shuma e projekteve të planifikuara për realizim

gjatë vitit 2009 i është lejuar shuma prej vetëm 24,31% dhe nga to nuk ka realizuar as një shumë për periudhën e shikuar 9 mujore të investimeve për këtë vit.

Ndërsa nga financimet e donatorëve e njëjta ka realizuar vetëm 72.974,00 € e cila në % arrin shumen prej vetëm 12,80%.

Kompania duhet të angazhohet për realizim të shumës së investimeve të lejuar për vitin 2009 se edhe kjo do të ngecë në zgjerim të bazës së vet të aseteve e cila do të ndikojë te ulja e vlerës së saj dhe do të mund ndeshet me faktin edhe të e zbritjes së tarifës së vitit 2010 për atë shumë të investimet të pa realizuara nga investimet vetanake.

4.4.2. TË DHËNAT SEKTORIALE TË PËRGJITHSHME PËR INVESTIME KAPITALE

Kur shikohet këto të dhëna nga aspekti historik afatshkurta mund të thuhet se kompanive u janë krijuar parakushtet që të fillojnë të krijojnë fitime të caktuar nga afarizmi i tyre dhe me to të realizojnë projektet të caktuar në shuma relativisht të vogla në përputhje me nevojat e tyre aktuale. Shuma e projekteve investive të planifikuara për financim nga burimet vetanake nga shtatë KRU-të për vitin 2009 ishin planifikuar të arrijnë në 7.173.825€, të cilën ZRRUM e ka korrigjuar duke e sjellë në shumë të përgjithshme prej 4.397.531€ e cila shprehur në % është 61,29% nga shuma fillimisht e planifikuar e cila do të mund të mbulohej me tarifën e viti 2009.

Nga gjithë kjo shumë e lejuar janë realizuar vetëm 340.576€ ose shprehur në (%) vetëm 7,74% e që as për së afërmi s'është e mjaftueshëm për të realizuar synimet e pritshme.

Shuma e planifikuar e projekteve dhe investimeve me financim të mundshëm nga donatorët ishte paramenduar se do të arrinte në 34,753,401€ e që për këtë periudhë të shikuar kohore ka arrit vlerën prej vetëm 4,27%, ose shprehur në vlerë absolute shuma e projekteve të realizuar ka arrit vlerën prej 1,484,218€ për këta 9 muaj të vitit 2009.

Kjo shumë e relativizon shumën e deklaruar ne raportin tonë të parë periodik, pas deklarimeve të KUR "Bifurkacioni" Sh. A. Ferizaj për 9 muajt e këtij viti.

Manaxhmentet dhe palët tjera të interesit të këtij sektori duhet të intensifikojnë angazhimin e tyre për realizim të planeve të tyre operative, financiare të kësaj periudhe 1-vjeçare dhe atë 3-vjeçare, pasi që sektori mund të bie në vështirësi në të ardhmen.

Realizimi i planeve operativo – financiare të viteve 2009 gjer në fund të vitit 1011 është parakusht për realizim të investimeve nga burimet financiare vetanake.

5. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIME

Ekipi i ZRRUM-it gjatë vizitave të realizuara me qëllim të hartimit të këtij raporti, është prit mjaft mirë nga KRU-të dhe mund të konstatohet se ka pas një përmirësim në krahasim me takimet e para të mbajtura për raportin e parë periodik. Kjo vlerësohet nga ZRRUM si një qasje pozitive dhe bashkëpunuese e KRU-ve të cilat kanë ofruar të gjitha të dhënat që i kishin në dispozicion në momentin e realizimit të vizitave.

Sigurisht që gjithmonë ka hapësirë për përgatitje më të mira dhe realizim më të suksesshëm të bashkëpunimit, dhe ZRRUM pret që në vizitat e ardhshme disa prej kompanive do të përgatiten edhe më mirë.

Kur flasim planet e kompanive për vitin 2009 për sasinë e ujit të prodhuar, si dhe për sasinë e ujit të faturuar nga distribucionet dhe grumbullimin e ujërave të zeza, shohim se as këto të dhëna nuk janë realizuar në përputhje me planet e tyre për këtë vit, respektivisht për këtë periudhë kohore. Dështime të theksuar ka te faturimi i ujit të prodhuar për këtë periudhë kohore të shikuar, pastaj te sasia e grumbullimit të ujërave të zeza kur shikohet kjo periudhë kohore. Kur i shikojmë të dhënat e tilla të vitit 2008 me ato të periudhës së njëjtë të këtij viti, shohim se parametrat e prodhimit të ujit te disa kompani janë përmbush e te disa të tjera jo, ndërsa faturimet në përgjithësi kanë dështuar në krahasim me planin e kësaj periudhe kohore, sikurse që ka dështuar edhe planifikimit i të hyrave të inkasuara nga faturimet për këtë periudhë kohore. Shuma e faturimeve është ma e ulët për 13,74% dhe ajo e inkasimit për 24,98%.

Shpenzimet për paga dhe për energjinë elektrike janë tejkaluar dukshëm tek të gjitha KRU-të, me përjashtim te KRU “Hidromorava” e Gjilanit (për pagat e kësaj periudhe kohore). Ndërsa kemi mosrealizim të shumave të planifikuar të shpenzimeve tjera operative në shumë shumë të larta, që mund të jetë me pasoja për të ardhmen e afarizmit të këtyre kompanive. KRU-të duhet të angazhohen në ndërrimin e këtij disproporcioni të shpenzimeve të bëra për pjesën e fundit të këtij viti dhe të vitet tjera pasuese.

Edhe realizimi i projekteve investive të planifikuara te të dy burimet e investimeve kanë dështuar dhe kjo duhet të jetë brengosësh për të gjitha palët e interesuara. Theks të veçantë i japim realizimit të projekteve nga burimet financiare vetjake të kompanive të cilat janë të ndërlidhura me realizim të gjithë parametrave të përcaktuar me procesin tariforë të këtij viti dhe të dy viteve të tjera pasuese.

Angazhimin e DFT-ës në realizim të kësaj pune dhe aktivitetet tjera të ndërlidhur me te e konsiderojmë si eksperiencë të mirë dhe të suksesshme, nga ku është fituar një përvojë e re e cila do të na ndihmojë për të konsoliduar të dhënat e nxjerra, dhe për të sqaruar disa çështje esenciale me përfaqësuesit e kompanive për vitet tjera dhe përcaktim të politikave të reja për të ardhmen dhe angazhim tonin konkret në përmirësimin e gjendjes së këtij sektori i cili është jetik.

Shtojca A: Procesi i Konsultimit me KRU-të për Gjetjet e Raportit

Me qëllim të evitimit të mangësive eventuale dhe pasaktësive me rastin e përpilimit të këtij raporti, ZRRUM ka zhvilluar një proces të konsultimit me KRU-të duke kërkuar komentet e tyre në draftin e raportit para se i njëjti të finalizohet.

Komentet e KRU-ve dhe përgjigjet e ZRRUM në ato komente janë dhënë në vijim me qëllim të sqarimit të çështjeve të ngritura nga KRU-të.

Shfrytëzojmë rastin ti falënderojmë të gjitha KRU-të për bashkëpunim.

1. Dërgimi i Draftit të Raportit për Komente të KRU-ve

From: Sami Hasani [sami.hasani@wwro-ks.org]

Sent: Wednesday, December 09, 2009 4:11 PM

To: 'Naim Mujaj'; 'r.maloku@hidrodrini.com'; 'maloku rasim';
'abdylazizi@hotmail.com'; 'Vehbi Braha'; 'Kastriot Zhaveli';
'fatushe_hetemi@yahoo.com'; 'mirlinda 2002'

Cc: 'Afrim Lajci'; 'Vehbi Duraku'; 'ymer fejzullahu'

Subject: Drafti i parë i Raportit të dytë periodik janar - shtator 2009
Koleg/e të nderuar/a,

Të bashkangjitur në këtë-mail do të gjeni Draftin e parë të Raportit tonë të dytë periodik për të dhënat operativo-financiare dhe ato të investimeve kapitale të punuar nga DFT/ZRRUM për KUR-ët për periudhën kohore janar – shtator 2009. Këto të dhëna janë mbledhë gjatë muajt tetor dhe mbulojnë 9 muajt e këtij viti, me përjashtim të KUR "Hidrodrini" Sh. A. Pejë e cila ka deklaruar të dhëna 8 mujore. Luteni që çdo njeri nga ana e juaj për kompanitë tuaja të epni vërejtjet dhe komentet tuaja eventuale me qëllim mënjanimi të lëshimeve apo gabimeve tona apo tuajat para se i njëjti të bëhet publik dhe të shfrytëzohet si material punues për diskutime të mëtutjeshme.

Çdo sugjerim i juaj do të jetë i mirëseardhur dhe do ta vlerësojmë shumë .

Sami Hasani, DFT/ZRRUM, Prishtinë

2. KOMENTET E KRU-VE

2.1. Komentet e KRU "H idrodrini" Sh. A. Pejë

From: malokurasim [malokurasim@yahoo.com]
Sent: Monday, November 23, 2009 1:14 PM
To: sami.hasani@wwro-ks.org
Subject: Raport
Pershendetje

KOMPANIA E UJËSJELLËSIT RAJONAL SH.A.



Zyret Qendrore
Rr. Gazmend Zajmi 5 30000 Pejë-Kosovë
Telefoni: +381 (0)39 432 355
www.hidrodrini.com

Per : ZRRUM Prishtine

Nga : KUR "Hidrodrini" SH.A

Lenda : Pagat per vitin 2009

Pagat e planifikuara per vitin 2009 jane 800.000,00€

Kurse pagat e realizuara per periudhen Janar – Tetor 2009 jane 681.877,00€

23.11.09

o *Përgjigja e ZRRUM në Komentet e KRU "Hidrodrini"*

From: Sami Hasani [sami.hasani@wwro-ks.org]
Sent: Friday, December 11, 2009 2:18 PM
To: 'maloku rasim'
Subject: RE: Drafti i parë i Raportit të dytë periodik janar - shtator 2009

Rasim,

Faleminderit për e-mailin tuaj të 10 Dhjetori 2009 me të cilin sugjeroni rishikimin e të dhënave dhe gjetjeve tona për fondin e pagave për periudhën e janar – tetor 2009.

Me të dhënat tuaj të fundit të ofruar kanë dalë disa ndryshime të cilat pasqyrojnë ngritjen e shpenzimeve për paga për 8 mujorin e shikuar e cila si ndikim ka ndikuar edhe shumë në shpenzimeve të përgjithshme nëse janë deklaruar drejtë.

Pasi që analizat tona janë bërë vetëm për periudhën 1 janar – 31 gusht 2009, përdhë kjo për të cilat ju keni deklaruar me rastin e vizitës sonë (19 Tetor 2009) edhe për kategoritë tjera të të dhënave operative, financiare dhe ato të investimeve kapitale, nuk kemi muajt me bërë ndryshim vetëm te pagat.

Paraqitja 8 mujore e të dhënave tuaja ka dalë si rezultat i mesatareve mujore të marra për këtë llogaritje dhe për të dhënat tjera të cilat janë bërë në mënyrë proporcionale, si për 8 apo 10 muaj, e në esencë nuk ndryshon asgjë, nëse diçka nuk është regjistruar ndërkohë në data bazën tuaj nga të dhënat e vjetar.

Unë në shtojcë po ta dërgojë këtë tabelë dhe komentet tona për të njëjtën që ju ta shikoni dhe nëse gjeni diçka që nuk është në rregull, luteni që serish të na kontaktoni.

Ju përshëndes,
Sami Hasani, DFT/ZRRUM, Prishtinë

Rishikimi numerik i të dhënave të ZRRUM-it ndaj "Hidrodrini" Sh. A. Pejë

Kompania	Kategoritë e shpenzimeve për periudhën; janar - gusht 2009	Ujë			Kanalizim		
		Historike	Aprovuar nga ZRRUM	Realizuar	Historike	Aprovuar nga ZRRUM	Realizuar
"Hidrodrini" Sh.A., Pejë (të dhënat 8 mujore)	Shpenzimet e pagave	486.814	487.666	490.702		45666	54800
	Shpenzimet e energjisë elektrike	143.080	100.666	162.353		0	
	Shpenzimet tjera operative	216.042	433.133	190.291		34500	
	Total shpenzimet operative	845.937	1.021.466	843.346		80166	54800

Prishtinë, 11. 12. 2009

DFT/ZRRUM

- **KUR "Hidrodrini" Sh. A. Pejë**

Fondi i pagave për periudhën e planifikuar 8 mujore të këtij viti të cilën DFT/ZRRUM e ka marrë për analizë, kjo kompani e ka tejkaluar 2,28% e cila në krahasim me disa simotra të saja është simbolike, ndërsa në mënyrë enorme janë ngritë shpenzimet e energjisë elektrike për të njëjtën periudhë kohore dhe atë për 61,28%, e shpenzimet tjera operative kanë mbet pa u realizuar për 59,31%. Kjo ka mundësuar që kompania shumë të përgjithshme operative ta këtë ma të ulët për 12,08% për të njëjtën periudhë kohore të shikuar.

Ndërsa kur krahasohen të dhënat e njëjta të vitit 2008 me vitin 2009 për të njëjtën periudhë kohore kemi një ngritje të shumës së shpenzime të përgjithshme operative për 6,17% gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008.

Kompania do të vepronte mirë sikur të ketë nën kontroll ma të mirë ekuilibrimin e shpërndarjes së shpenzimeve brenda grupimeve të caktuara për të mos ulur nivelin e shërbimit. Përndryshe, shumta e shpenzimeve është me e ulët për 12,08% se sa shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë i cili është një sinjal i mirë për këto të dhëna pa hy në elaborimin e tyre të mëtutjeshëm. Ne, shpresojmë se ulja e shpenzimeve në nivelin e planifikuar nuk ka ulur edhe nivelin e planifikuar të shërbimit për konsumatorët dhe nëse

qëndron ky konstatim, kjo do të ishte një gjë pozitive sepse mundëson që këto mjete të shfrytëzohen për investime kapitale.

Kërkohej nga kompania që të mbaj të dhëna të ndara për të dy shërbimet e veta, se është evidente se për shërbimet e kanalizimit nuk ka prezantuar asnjë të dhënë dhe kjo është në kundërshtim me metodën e mbajtjes së të dhënave sipas kontabilitetit rregullator të aprovuar dhe akorduar s'bashku.

2.2. Komentet e KRU "Hidromorava" Sh. A. Gjilan

From: abdulaziz selmani [abdulazizi@hotmail.com]

Sent: Tuesday, December 15, 2009 3:21 PM

To: Sami Hasani Zrrum

Subject: Koment ne Raportin e dyte

Pershendetje z. Sami ne vazhdim po ju dergoj disa komente (edhe pse e di qe ndoshta eshte vonë) ne lidhje me Raportin e Dyte.

Per qdo pakjartesi degjohemi,faleminderit!



Kompania Rajonale për Ujë dhe Kanalizim

"Hidromorava" SH.A

Regionalna Kompanija za Vodovod i Kanalizaciju

"Hidromorava" D.D

Regional Company for Water and Sewerage

"Hidromorava" J.S.C. Gjilan

Për: z.Sami Hasani - ZRRUM

Nga: z. Abdulaziz Selmani – KRUK "Hidromorava" Sh.A.

Lënda: Koment në Raportin e Dytë Periodik

Përshëndetja z. Sami,

Jam i vetëdijshëm se ndoshta është edhe vonë për këto komentime,por të lutem nëse mundesh të më shpjegosh pak për këto shënime sepse nuk i kam të qarta këta indikator,parapakisht ju faleminderoj!

1. Faqe nr. 8 Uji i Prodhuar te kolona të Aprovuara nga ZRRUM qëndron shënimi 6.652.500 m3
-sipas shënimit të planit të Biznesit të aprovuar për vitin 2009 uji i prodhuar planifikohe te jet 7.045.680 m3 ku / 12x9 = 5.284.260 m3 ,
- si dhe elementi tjetër – Uji i faturuar sipas Aprov. Nga ZRRUM qëndrën shënimi 3.907.470 m3, ndërsa sipas shënimit të Pl.Biz. të aprovuar për 2009 i njejt shënim planifikohet të jet 3.336.405 m3 ku /12x9=2.502.304 m3,
Kështu që nëse kështu merren këto shënime ather edhe në faqen 11 kemi një ndryshim në tekst ku në vend të -22,20% duhet të jetë +2,10% , e po ashtu edhe për faturimin -42,02% duhet të jetë +7,10%.
Z.Sami po mendojm nëse kështu llogariten.

2. Po ashtu edhe te shpenzimet në faqen 15, te kolona të realizuara për 9 muaj të vitit 2009 figuron të jetë shënimi $517.742 \text{ €} + 7.860 \text{ €} = 525.602 \text{ €}$ e që në fakt për 9 muaj të vitit 2009 total shpenzime kemi të krijuara dhe raportuara 765.151 €.
- 3.
4. Edhe te të dhënat e faturimit dhe inkasimit faqe nr. 21
 - faturimi i aprovuar qëndron $(965.735+214.111) = 1.179.846 \text{ €}$ ndërsa sipas PL.Biz. qëndron $(1.468.018 / 12 \times 9) = 1.101.013 \text{ €}$,
 - edhe faturimi i realizuar për 9 muaj në tabel figuron $(684.007 + 144219) = 828.226 \text{ €}$ ndërsa i realizuar tek ne qëndron 995.330 €.
 - Edhe inkasimi në tabel qëndron $(738.113+161844) = 899.957 \text{ €}$, ndërsa i pla.sipas Pl. Biz. për vitin 2009 është $1.284395/12 \times 9 = 963.296 \text{ €}$, ndërsa inkasimi i realizuar për 9 muaj të 2009 është $(617.893 + 56.231) = 674.124 \text{ €}$.

Me respekt, Abdylazizi Gjilan!

Rr. Avdulla Tahiri p.n. Gjilan – Kosovë, Tel: +280 (3) 25 658

o ***Përgjigja e ZRRUM në Komentet e KRU "Hidromorava";***

From: Sami Hasani [sami.hasani@wwro-ks.org]

Sent: Wednesday, December 16, 2009 4:55 PM

To: 'abdylaziz selmani'

Cc: 'Afrim Lajci'; 'Vehbi Duraku'; 'ymer fejzullahu'

Subject: RE: Koment ne Raportin e dyte

I nderuari z. Abdylaziz,

Lidhur me e-mailin tuaj të djeshëm ju njoftojë se ne kemi verifikuar edhe njëherë gjatë tërë ditës së sotme të dhënat e e-mailit tuaj të djeshëm dhe ato të dokumentacionit tonë përfundimtarë të përmbledhura në dokumentin e emërtuar, si; Plotësimi Raportit Përfundimtarë për Tarifa Shërbimi për periudhën 2009 – 2011 i cili mban numrin e regjistrimit 549/D, datë 15 dhjetor 2009 dhe ato të Raportit tonë të dytë periodik të dërguar tek ju me 9 dhjetor 2009.

Pas dërgesës sonë të dokumentit tonë të emërtuar si Plotësim të Raportit Përfundimtarë për tarifa shërbimi për periudhën 2009 – 2011, ne asnjëherë nuk kemi marrë ndonjë koment për mëdyshjet tuaja lidhur me to, të cilat do të mund të ishin bazë për rishikim eventual të procesit të përcaktuar të tarifave. Tani kur disa të dhëna domosdo dalin në sipërfaqe, dëshironi të njëjta ti kontestoni pa ndonjë mbështetje të bazuar. Por të shkojmë radhazi.

Plotësim i Raportit përfundimtarë të datës 17 nëntor 2009 ka qenë bazë për përcaktim të tarifave të viteve 2009, 2010 dhe 2011 dhe të njëjtat mbështeten në 4 aplikacionet tuaja për të njëjtat periudha kohore dhe shumë takimeve tona të përbashkëta për këtë çështje, prandaj gjithë të dhënat e deklaruar në raportin e tonë të dytë periodik, të ndërlydura me sasinë e ujit të prodhuar dhe faturuar për këta 9 muaj të shikuar mbeten të pa ndryshuara për periudhën e shikuar, pasi që janë të saktë.

Edhe rast i shpenzimeve operative është i njëjtë, pasi që të njëjtat dëshmojnë konstatimet tona të cekura ma lart për sa i përket prodhimit dhe faturimit, se bazë për përcaktim të

tarifave të procesit të fundit rregullatorë, kanë qenë deklarimet tuaja insistuese, pa i rishikuar mirë të dhënat tuaj që ju vet i keni prezantuar në ZRRUM.

Për me mbuluar shpenzimet tuaja të deklaruara për afarizmin ne po i referohemi edhe e-mailit tuaj të fundit, të datës 15 dhjetor 2008, kur deklaroni se shpenzimet tuaj përfundimtare janë 1.443.983,00 €/vit. Të cilat ne serish i kemi rishikuar me të drejt, pasi që kjo po vërtetohet edhe tani dhe të njëjtat i kemi aprovuar në 1.200.155,00 €/vit, të cilat serish janë ma të larta për këtë periudhë kohore prej 41,61%, nga sa i keni shpenzuar për 9 muajt e kaluar dhe me strukturë të jo të ekuilibruar mirë.

Jo konsekuenca e juaj te të dhënat operative; prodhimi dhe faturimi i ujit, numër i konsumatorëve, shpenzimet operative etj., na kanë bërë që të njëjtat ti cilësojmë shumë herë si shumë konfuze dhe jo të besueshme, çka po vërtetohet edhe tani.

Ju asnjëherë gjerë me këtë rast nuk keni adresuar çështjen e dokumentit tonë të fundit për procesin e udhëhequr tariforë e as për raportin tonë të parë periodik dhe fatkeqësisht ne të dhënat tona në këtë fazë nuk mund ti korrigjojmë në as një formë.

Në rast se marrim ndonjë kërkesë tuajën për këtë çështje, ne në ZRRUM do të marrim një vendim adekuat për rishikim eventual të procesit tariforë për dy vitet e mbetura, 2010 dhe 2011. Rishikim i jonë eventual do të shkojë në drejtim të zbritjeve të inputeve hyrëse operative e sigurisht dhe atyre dalëse, pra, uljen edhe të tarifave për dy vitet e mbetura. Ky vendim do të merret pas diskutimeve që do të bëhen këtë zyrë.

Nëse eventualisht vazhdoni të keni dilema lidhur me çështjet e trajtuar në këtë e-mail, ju kisha sugjeruar për mbajtjen e një takimi të veçant, ku do të sqarohen gjerat e ngritura një nga një dhe mënjanohen dilemat e ngritura përfundimisht rreth kësaj çështje.

Ne na vjen keq, që kjo çështje po ngritët pas një viti e nuk është bërë në gjë i tillë në momentin dhe kohën e duhur.

Me respekt,
Sami Hasani, DFT/ZRRUM, Prishtinë

From: abdulaziz selmani [mailto:abdulazizi@hotmail.com]

Sent: Tuesday, December 15, 2009 3:21 PM

To: Sami Hasani Zrrum

Subject: Koment ne Raportin e dyte

Pershendetje z. Sami ne vazhdim po ju dergoj disa komente (edhe pse e di qe ndoshta eshte vone) ne lidhje me Raportin e Dyte.

Per qdo pakjartesi degjohemi,faleminderit!

Windows Live: [Friends get your Flickr, Yelp, and Digg updates when they e-mail you.](#)

2.3. Komentet e KRU "Bifurkacioni" Sh. A. Ferizaj

From: Fatushe Hetemi [fatushe.hetemi@bifurkacioni.com]

Sent: Thursday, December 17, 2009 12:15 PM

To: sami.hasani@wwro-ks.org

Subject: Sqarime për Raportin e dytë Periodik

Përshëndetje Z.Hasani,

Kompania „Bifurkacioni" të dhënat e dërguara për aplikimin në procesin tarifor 2009-2011 i ka dërguar edhe për Njësinë në Kaçanik , e cila njësi nga muaji Shkurt 2009 nuk ka bashkëpunuar gjegjësisht nuk kemi të dhëna për të arkëtimet dhe kostot e saj.

Po ashtu edhe planifikimi është bërë edhe për këtë njësi, në të dhënat e dërguara nga Kompania „Bifurkacioni".

Prandaj mendoj se raporti nuk mund të krahasohet për vitin 2009 dhe planifikimet.

Z.Hasani, kam disa pyetje për tabelat nr. 2 dhe nr.3, të cilat të dhëna unë mendojë se ne i kemi shumë të besueshme, por sigurisht përshkak të angazhimeve të cilat i keni ju pa dashje janë prezentuar në raport jo saktë.

Tabela 2. shpenzimet për personelin (historike ujë- 356,429.00€ dhe kanalizim s'ka të dhëna) as për 9 muaj 2008 dhe as për 12 muaj nuk i kemi ashtu siç janë prezentuar, besoj është ndonjë gabim teknik. Edhe në kontabilitet dhe raportet e dërguara, kosto e stafit për 9 muaj e kam të regjistruar 279,743.50€ ,shpenzimet e rrymës për 9 muaj 18,189€ dhe tjerat operative 141,313.00€

Shpenzimet e aprovuara nga ZRRUM - Kur kemi aplikuar në aplikacionin e tarifave të dhënat e vitit 2007-08-09-deri në vitin 2011, ne kostot e stafit përveq për ujë dhe kanalizim i kemi kalkuluar edhe kostot e stafit të shërbimit me konsumatorë, kështu që duhet të merren parasysh edhe këto kosto në totalin e shpenzimeve të personelit. Në aplikacionin tonë të tarifave 2008 kostot e personelit i kemi prezentuar total 338,784.9 në vitin 2009 342,922.00, e tutje sipas formularit, pra jemi munduar edhe me detalisht ti ndajmë shpenzimet por si duket nuk janë plotësuar sipas kërkesës së formularit.

Tabela nr3. Edhe faturimi edhe inkasimi edhe të dhënat historike edhe të realizuara pa i marr parasysh të dhënat e provuara nga ZRRUM- nuk përputhen me shënimet tona. Përveq, në të dhënat historike 9 muaj 2008 për inkasimin 584,401.00€ janë të paraqitura të dhënat me TVSH. Inkasimi total realisht është ashtu, por duhet të jetë më i vogël për 76,923.00€ respektivisht 512,821.00€ dhe atë për 12 muaj.

Me respekt,

Fatushe Hetemi - Menaxhere e Adm. dhe Financave

044/224-302

fatushe.hetemi@bifurkacioni.com

www.bifurkacioni.com

o *Përgjigja e ZRRUM për komentet e KRU "Bifurkacioni"*

Për shkak të marrjes me vonesë të komenteve të kësaj kompanie, përgjigja e DFT/ZRRUM nuk mund të bëhet menjëherë pasi që i gjithë materiali është përfunduar për këtë raport, por e njëjta do të bëhet gjerë në fund të këtij muaj, me të cilat do të njoftohet kompania.